

Ali Fuad Bashgil

KOKË MË KOKË ME TË RINJTË

Logos-A

Shkup, 2000

Ali Fuad Bashgil

KOKË MË KOKË
ME TË RINJTË

Logos-A

Shkup 2000

Titulli i origjinalit
Prof. Ali Fuad Başgil
GENÇLERLE BAŞBAŞA
Botues
YAĞMUR YAYINEVİ
İstanbul, 1983

Shqipëroi
Mr. Metin Izeti

Copyright © by *Logos-A*, 2000

CIP - Каталогизација во публикација
Народна и универзитетска библиотека "Климент Охридски", Скопје

297

BASHGIL, Ali Fuad

Kokë më kokë me të rinjtë / Ali Fuad Bashgil; shqipëroi Metin Izeti. -
Shkup: Logos-A, 2000. - 81 стр.; 20 cm. - (Biblioteka Mendimi islam)

Превод на делото: Gençlerle Başbaşa

ISBN 9989-904-10-3

Ali Fuad Bashgil

KOKË MË KOKË ME TË RINJTË

Jetëpërshkrimi i autorit

Ali Fuad Bashgil u lind në vitin 1893 në komunën e Çarshambës, rrethina e qytetit të Samsunit. Babai i tij ishte Mehmet Shukri efendiu, kurse nëna Fatime Nyvide hanëmeja. Gjysh e kishte Hafiz Ibrahim efendiu nga familja e njohur Bolykbashogullar. Zotëri Ali Fuadi si djalë i një familjeje të njohur shkollën fillore e kreu në Çarshambë, një pjesë të së mesmes në Stamboll ndërsa pjesën e fundit në Paris.

Shërbimin ushtarak e mbaroi si epror i ushtrisë osmane në frontin e Kaukazit gjatë Luftës së Parë Botërore. Në fronte të ndryshme qëndroi 4-5 vjet, kurse shkollimin e mbaroi pas kthimit.

Ali Fuad Bashgil e kreu me sukses Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Grenobëlit, ndërsa doktoratin në Fakultetin e Drejtësisë në Paris. Në të njëjtin universitet diplomoi edhe në Degën e Filozofisë pranë Fakultetit të Letërsisë dhe në Shkencat Politike. Njëkohësisht i vijoi edhe kurset e Akademisë për Drejtësi Ndërkombëtare në Hagë. Në vitin 1929 u kthye në vendlindje me tri diploma fakulteti, me një të shkollës së lartë dhe me titull doktori.

Punësimi i tij i parë u bë në Ministrinë e Arsimit të Lartë ku ushtroi detyrën e zëvendës drejtorit të Arsimit të Lartë. Në vitin 1930 me sukses të shkëlqyeshëm e dha provimin e docenturës në Fakultetin e Drejtësisë në Ankara, kurse një vit më vonë fitoi titullin e profesorit të rregullt në po të njëjtin fakultet. Deri në vitin 1933 ligjëroi lëndën e Të Drejtës

Romake në Fakultetin e Drejtësisë, kurse në Institutin Edukativ-Arsimor të Gazi-së ligjëroi Historinë e Qytetërimit.

Pas vitit 1933 u emërua profesor në lëndën e Të Drejtës Organizative në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Stambollit, por në të njëjtën kohë ligjëronte edhe në Shkollën e Lartë të Shkencave Politike. Në vitin 1936 u emërua drejtor i Shkollës së Lartë Tregtare-Ekonomike në Stamboll, në të cilën shkollë si dhe në Fakultetin e Drejtësisë në Stamboll për herë të parë në Turqi nisi dhe ligjëroi lëndën e Të Drejtës së Punës.

Ndërmjet viteve 1937-1942 ushtroi postin e dekanit në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Stambollit, ndërsa më vonë ligjëronte në Fakultetin e Drejtësisë dhe në Shkollën e Lartë të Shkencave Politike në Ankara. Një kohë ishte edhe drejtor i Shkollës së Lartë të Shkencave Politike si dhe profesor i Të Drejtës Organizative. Në vitin 1943 dha dorëheqje në postin e drejtorit dhe kaloi në Universitetin e Stambollit ku ligjëronte të Drejtën Organizative. Në këtë detyrë mbeti deri në vdekje dhe si profesor i rregullt nxori me mijëra studentë.

Në vitin 1961 u zgjodh prefekt i Samsunit por pas një kohe shumë të shkurtër dha dorëheqje. Më vonë punoi në Zvicër ku edhe botoi një vepër në gjuhën frënge, e cila më vonë u përkthye edhe në gjuhën turke. Në vitin 1965 u zgjodh deputet nga Stambolli dhe sërish hyri në Parlamentin e Madh Kombëtar të Turqisë.

Vdiq më 17 prill të vitit 1967 në shtëpinë e tij në lagjen e Platonit në Feneryollu, ku jetonte së bashku

me bashkëshorten e tij, Fatime Nyvide hanëmen. Sot kjo lagje e mbanë emrin e tij.

Varri i tij gjendet përballë stacionit Çiçekçi në Varret e Karaxhaahmetit në Yskydar të Stambollit.

Merhumi dhe i nderuari profesor Ali Fuad Bashgil në një rën anë nxori numër të madh studentësh, kurse nga ana tjetër e përfaqësoi Turqinë në kongrese të shumta ndërkombëtare. Pas vete la shumë vepër të shkruara si në gjuhën turke ashtu edhe në atë frënge. Shkrimet e tij të botuara nëpër gazeta të ndryshme ndërmjet viteve 1930-1967 kanë dhënë një kontribut të dukshëm në ngritjen e vetëdijes së popullit të Turqisë. E kemi borxh që emrin e tij ta përmendim me rahmet.

Shtëpia Botuese Jagmur

Para se të fillojmë

Gjatë ditëve studentore në Francë, së bashku me një shok timin francez kërkonim vend ku së bashku¹ do ta kalonim pushimin veror. Së fundi vendosëm që të ndalemi në fshatin Revel që shtrihej përreth lumit Isere brenda pishnajave të dendura të alpeve. Ky fshat gjendej në një lartësi mbidetare 600 metërshe dhe ishte mjaft i qetë. Na pëlqeu shumë andaj kërkuam vend për vendosje. Na drejtuan drejt shtëpisë së priftit të Revelit, zotëri Girardit. Trokitëm në derë të tij. Derën e hapi një grua e plotë e me qafë të gjerë e cila na pyeti se ç'kërkonim. I thamë se jemi studentë, se vijmë nga Parisi dhe se kërkojmë vend për vendosje gjatë pushimit. "Me gjithë qejf", - u përgjigj ajo. Mirëpo, unë menjëherë u thellova në mendime. Për një moment më shkrepni në mendje se kjo shtëpi është pronë e fondacionit të kishës dhe se pronarët e saj janë njerëz që shërbejnë në kishë. Prandaj pa mos u menduar shumë i thash vetes se më mirë është që mos t'i hyhet një aventure e cila në fillim të gëzon por në fund të dëshpëron, kështu që pikërisht për këtë i tregova pronarit se jam musliman turk. Zonja e cila tërë jetën e saj e kishte kaluar në

¹ Ky shoku im ishte mik i njohur i turqve, Marcel Girsardi, i cili punoi në Konsullatën e Francës në Stanboll dhe në Ambasadën e Francës në Ankara. Është ekspert i turqishtes dhe historisë turke, e njëkohësisht ka botuar edhe një fjalor xhepi turqisht-frëngjisht. Paris, Garnier Freres, 1930.

lartësitë e alpeve, për një moment u ndal dhe tha se duhej të konsultohet me vëllain e saj.

Pak më vonë para nesh u paraqit një prift me mantel të zi, flokë të thinjura e trup të shëndoshë dhe pyeti se cili prej nesh është musliman turk. “Unë”, - i thash. “Mirë pra, - tha ai - meqë jeni musliman do të thotë se jeni besimtar, nuk ka problem. Armiq tanë në këtë epokë nuk janë besimtarët, pa marrë parasysh cilës fe apo cilit popull i takojnë, por janë pabesimtarët. Urdhëroni, jeni mysafirë tanë”. Aty për aty kuptova se prifti ishte njeri me horizont të gjerë. E falënderuam dhe u vendosëm në dhomë. Më vonë kuptuam se ky njeri i formuar vite me radhë kishte qenë profesor kolegji, por për t’i kaluar në qetësi vitet e fundit të jetës ishte vendosur në këtë fshat të qetë të alpeve. Në shtëpi pos nesh kishte edhe dhjetë studentë tjerë francezë. Zotëri Girardi një grupi prej tyre u mbante ligjërata në gjuhën latine. Edhe ne iu bashkangjitëm grupit. Njëkohësisht dëgjonim dhe argëtoheshim por edhe mësonim gjëra me rëndësi. Sidomos në netët e freskëta të alpeve Girardi na tubonte rreth vete dhe na bënte një gosti të këndshme plot mendime dhe ide të ndryshme. Të gjithë, të vegjël e të mëdhenj e dëgjonim me vëmendje të plotë. Sa të këndshme ishin ato ditë! Kohë pas kohe përsiatja e këtyre momenteve madje vlen sa e tërë bota.

Të mos e zgjasim tepër. Një ditë gjatë bisedave të rregullta Girardi na rekomandoi një libër dhe na tha se gjithsesi duhet ta lexojmë. Ky ishte libri “Edukimi i Vullnetit” shkruar nga ana e rektorit të Uni-

versitetit të Shën Marselit, moralistit dhe edukatorit të famshëm Jules Payot².

Të nesërmen shkova në qytet dhe e bleva librin. Hyra thellë në pyjet e dendura plot gjelbërim të Revelit, u ula nën hijen e një ahu të vjetër dhe fillova ta lexoj librin. Gjatë leximit fillova të ndjej një dëshpërim dhe dhimbje e cila ishte e përzier me një pendim të paqartë: Ah, sikur këtë libër ta kisha lexuar në moshën 17-18 vjeçare, - i thashë vetes dhe isha i dëshpëruar për shkak të vonesës. Brenda dy ditëve e lexova librin. Pasi e lexova përzemërsisht e falënderova zotëri Girardin. Ai u gëzua shumë dhe më tha që në kohë të lirë është mirë që t'i lexoj edhe këto vepra:

-*Puna Intelektuale dhe Vullneti*³

-*Arti i të mësuarit*⁴

-*Puna Intelektuale*⁵

-*Organizimi i punës intelektuale*⁶

² *L' Education de la volonte*, Paris, lib, Felix Alcan, 1922.

³ *Le travaille intellectuel et la volonte*, par Jules Payot, Paris, lib. Felix Alcan 1952.

⁴ *L'art d' apprendre*, par Marcel Provest (de L Academie Française) Paris, Ernest Flammarion, editeur).

⁵ *Le travail intellectuel*, par Albert Cim. Paris, lib. Felix Alcan, 1924.

⁶ *Organisation du travail intellectuel*, par Dr. P. Chavigny. Paris, lib. Delagrabe, 1920.

Unë këtyre veprave ua shtova edhe të mëposhtmet:

- Përfitimi i Lumturisë*⁷
- Filozofia e Lumturisë*⁸
- Shkenca e Lumturisë*⁹
- Suksesi nëpërmjet vullnetit*¹⁰
- Karakteri*¹¹
- Shkolla dhe Karakteri*¹²

Këto ishin vepra shkencore të shkruara pikërisht për ngritjen dhe udhëzimin e rinisë. Në kohë të lirë i lexova të gjithë këta libra, madje disa i lexova nga dy-tri herë. Mësova shumë gjëra të reja në lidhje me jetën dhe përherë Girardin e përkujtoja për të mirë. Por, i respektuari lexues, dëgjo me vëmendje. Nuk mund të them se vepra dhe se sot vepror sipas tyre. Për fat të keq, shkenca nuk e bën të domosdoshëm veprimin sipas saj. Për shembull, njeriu shumë mirë e di se pirja e duhanit është e dëmshme për shëndetin e tij, por shumë rrallë vepron sipas kësaj diturie dhe s'largohet prej duhanit. Kjo është kështu për shkak se burimi i shkencës është intelekt i kurse i veprimit - vullneti. Që edukimi i vullnetit të japë frytet e veta duhet të fillohet shumë herët me të. Meqë

⁷ La Conquete du zonneur, par Jules Payot, Paris, lib. Felix Alcan 1921.

⁸ Philosophie du bonheur, par Paul Janet, Claman-Ley, editeur.

⁹ La science du bonheur, par Jean Finot, Paris, Arthem Fayard.

¹⁰ Le succes par la volonte, par O.S. Marden, traduction francais, Geneve, J.H. Jeheber, editeur 1923.

¹¹ Le Caractere, par A. Burloud, Presse Universitaire de France.

¹² L'ecole et la caractere, par F.V. Foerster, Delechaux-Nistle, Paris.

disa shprehi bëhen të zakonshme dhe thellë i lëshojnë rrënjët e tyre, edukimi i vullnetit është shumë i vështirë. Njëkohësisht që të arrihet sukses në këtë lëmë, është më se i nevojshëm durimi i Ejjubit a.s.

Por, vetëm një gjë më ngushëllon, se ato gjëra që i kam mësuar së bashku me arritjet dhe përvojat e mia, gjithnjë jam munduar t'ua mësoj të rinjve. Vazhdimisht dëshiroja që të rinjtë t'i shoh të armatosur me virtytet më të mira të cilat i kam pëlqyer, por që në përgjithësi nuk kam pasur mundësi t'i jetësoj. Mendova të shkruaj dy-tri fjalë rreth kësaj, mirëpo është shumë vështirë që njeriu i cili nuk është moralist të shkruajë në këtë lëmi. Madje, kjo temë edhe e kalon kufirin e specializimit. Megjithatë, në gjuhën turke nuk ka asnjë vepër që do të shërbente si udhërrëfyese për punë, nevojë të cilën e vërejta te shumica e të rinjve me të cilët isha në kontakt.

Së fundit, në dimrin e vitit shkollor 1943-1944 m'u dha mundësia: Shtëpia popullore* e Eminonut kërkoi prej meje që të përgatis një ligjëratë. Përgatita ligjëratën me titull "Këshilla për rininë" e cila zgjoi interesim të madh. Shumica e dëgjuesve, qoftë drejtpërdrejt qoftë nëpërmjet letrave, kërkuan prej meje që të njëjtën ta botoj. Ligjëratat i përmbante momentet më të rëndësishme që janë prezentuar në këtë broshurë. Këtë ligjëratë e zgjerova edhe më tepër dhe e botova si trajtesë në gazetën "Xhumhu-

* Në vitet gjashtëdhjetë në Turqi janë hapur vende të posaçme të ashtuquajtura Shtëpi popullore (Hallkevi), me qëllim të çrrënjësjes së analfabetizmit në masat e gjera popullore dhe vërtet kanë dhënë kontribut të dukshëm në këtë drejtim. (Përkth.)

rijjet”. Kaluan dy-tri vjet. Në vitin 1947 edhe Shtëpia popullore e Yskydarit kërkoi të mbajë një ligjëratë në të. Aty mbajta një ligjëratë që kishte karakter plotësues të ligjëratës së mëparshme dhe mbante titullin “Ndikimi i edukatës në karakterin e njeriut”. Këtë ligjëratë e botova në gazetën “Tasvir”.¹³

Kështu pak a shumë ishte tubuar një material bazë. Këtij materiali i shtova edhe disa gjëra. E përpunova dhe e pasurova temën edhe më tepër dhe në këtë mënyrë para lexuesit u paraqit kjo broshurë e vogël modeste.

* * *

Të jem më konkret, kjo broshurë nuk është vepër shkencore si veprat të cilat i përmenda më lartë. Ajo është një udhërrëfyes që do t’u shërbejë brezave të rinj pa përvojë të punëtorisë mendore.

I respektuari lexues, a e di se ky grup është më mbrapa dhe në pozitë më të vështirë se ata që punojnë në punë fizike. Dihet mirëfilli se çdo çirak kur e fillon artizanatin e vet është pranë mjeshtrit dhe punon nën mbikëqyrjen e tij. Ai me sytë e vet sheh si punon një njeri që e njeh zanatin dhe vetë e kupton se fuqia fizike nën urdhrin e intelektit dhe vullnetit arrin suksese të duhura në punë. Ai e shijon kënaqësinë e prodhimit dhe suksesit në fund të punës konstruktive. Prej mjeshtrit të vet mëson mënyrën e punës dhe lehtësinë e kapërcimit të vështirësive. Madje gjatë krizave që mund t’i paraqiten në moshën rinore, ai gjithmonë pranë vete e ka mjeshttrin si mbështetje shpirtërore. Çirakët e punës ideore nuk

¹³ Këtë ligjëratë më vonë e botoi edhe revista “Jeni Mexhmua”.

kanë mbështetje të këtrillë shpirtërore dhe janë larg këtyre dobive. Këta nuk punojnë krah për krah me profesorët e tyre të cilët duhet të zënë vendin e mjeshtrit. Ata nuk shohin se si punon profesori i tyre dhe me të takohen vetëm në ligjërata dhe në provime. Atëherë profesori nëse nuk e merr përgjigjen e kërkuar për pyetjen të cilën e ka bërë vetë, thotë se nuk kanë mësuar ose nuk janë përgatitur si duhet. Por, këta çirakë të papërvojë medoemos duhet të zbulojnë se si duhet të mësohet, të zbulojnë mënyrën e të mësuarit dhe ta gjejnë mbështetjen shpirtërore e cila gjithsesi u nevojitet. Nëse nuk mund ta gjejnë, digjen e shkojnë. Se sa të rinj shkatërrohen pikërisht për këtë, vetëm Allahu e di. Shkaku kryesor dhe parësor i dëshpërimit, pesimizmit dhe shkatërrimit shpirtëror të shumica e të rinjve pa dyshim është ky. Respektivisht, në njërin anë nuk e njohin mënyrën e të mësuarit ndërsa në anën tjetër, nuk kanë mbështetje shpirtërore. Jam i bindur se këtë zbrazëtirë dhe mangësi e ndjenë çdo i ri dhe njëkohësisht e shijon shijen e idhët të tyre. Këtë gjë edhe ne e shijuam dhe e përjetuam, meqë edhe ne ishim studentë dhe çirakë të jetës ideore.

Dëshiroj që shkollat tona që prej fillores e deri te më të lartat të rinjve gradualisht t'ua mësojnë mënyrën e ecjes me hapa të sigurt në rrugën e të mësuarit dhe përgatitjes; t'ua zbulojnë fshehtësinë e suksesit në punë. Shkolla të mos i ngjasojë një fabrike e cila prodhon dituri dhe të mos mbetet vetëm në intelektet e të rinjve, por le të ndalet pak edhe në vullnetin e tyre dhe shpirtërisht le t'i edukojë ata, për arsye se vlera dhe fuqia e njeriut mbështeten në

dominimin me unin dhe sundimin me vullnetin, në sjelljet e mira dhe edukatën shpirtërore e jo në sasinë e diturisë. Edukata e shpirtit dhe vullnetit është diç krejtësisht tjetër. Kjo edukatë nuk arrihet me leximin dhe mësimin përmendsh të librave. Çdonjëri prej nesh e di se në klasat tona të mbushura përplot me të rinj askush nuk merret me këtë problematikë.

Ja pra, duke e pasë parasysh këtë zbrazëtirë dhe duke u bazuar në atë që kam lexuar dhe përjetuar në jetën time studentore dhe mësimdhënëse, vendosa që rinisë t'i prezentoj një mendim për atë se si arrihet në fshehtësinë e të qenit i suksesshëm dhe për mënyrën e të mësuarit dhe punës. E di mirë që çdo i ri pret dhe prej çdo të riu pritet që të jetë i suksesshëm. Respektivisht, nëse është në shkollë - ta kryejë atë, ndërsa nëse është në shoqëri - të ngrihet në vendin dhe pozitën e merituar. Shoku im i ri! Nuk pohoj se do të ta tregoj rrugën më të drejtë dhe më të sigurt e cila do të të shpie në këtë cak.

Në të vërtetë të jeshë i suksesshëm nuk do të thotë të jeshë edhe i lumtur. Njeriu mund të arrijë sukses, të ngrihet edhe në vendin të cilin nuk e meriton në shoqëri, por kjo nuk do të thotë se është edhe i lumtur. Sa njerëz ka që kanë arritur kulmin e pasurisë, pushtetit dhe famës por brendia e tyre digjet nga malli i lumturisë. Mund të takosh njerëz të shumtë të cilët janë të gatshëm që banesat e veta të rehatshme dhe luksoze t'i ndërrojnë me një ditë lumturi, për arsye se lumturia është çështje shpirtërore që gjendet në brendinë tonë. Kërkimi i lumturisë diku tjetër jashtë vetes sonë, në famë, pasuri dhe

pushtet, konsiderohet si mashtrim optik në shkretëtirën pa ujë.

Por megjithatë, rruga e lumturisë nuk është e ndarë nga rruga e suksesit. Atdheu i lumturisë është pak më tej atdheut të suksesit. Para se të kalohet ky vend nuk mund të arrihet në atdheun e lumturisë, ose mundet por është shumë vështirë. Njeriu i suksesshëm me pak mund lehtë mund ta arrijë lumturinë.

Udhëtari im i dashur, në këtë broshurë do të mundohem të ta tregoj rrugën e atdheut të suksesit. Nëse dëshiron të shkosh më tej, atëherë do të vazhdosësh vetë dhe do ta gjesh lumturinë e kërkuar.

Fenerjollu, Maj 1949

I

Rreziqet dhe armiqtë e rrugës së suksesit

Udhëtar i ri i rrugës së ngritjes dhe suksesit! Dije që në rrugën në të cilën ke filluar të hapërosh ka shumë gryka të rrezikshme dhe kaçakë të cilët ta presin rrugën. Në të vërtetë çdo udhëtar i rrugës jetësore has në këto vështirësi. Por, këta armiq me gjithë qejf dëshirojnë t'i sulmojnë të zemërdëlirët e papërvojë të cilët janë në prag të jetës. Kjo nuk do të thotë se ti nuk ke armë me të cilën do t'i luftosh dhe do t'i mposhtish ata. Mjafton që të dish t'i përdorish këto armë. Nëse nuk di t'i përdorish dhe nëse njëherë e humbë betejën, vështirë do t'i kthehesh përsëri asaj. Më lejo që së pari të t'i tregoj armiqtë të cilët presin të kalosh dhe rreziqet me të cilat do të ballafaqohesh.

* * *

Armiku i parë i suksesit është përtacia

Armiku yt i parë në rrugën e suksesit është përtacia. Këtu nuk mendoj ta përkufizoj këtë shprehje të dëmshme. Atë edhe unë edhe ti, ne të gjithë pak a shumë e dimë, për arsye se që moti është thënë se njeriu është gjallesë përtace. Por, unë ty do të them vetëm një gjë, - përtacia nuk është armik i cili i del përpara njeriut dhe përleshet me të si burrat. Përkundrazi, përtacia është një frikacake që merr forma të ndryshme si trimat e tregimeve të vjetra dhe duke përdorë me mijëra dredhi mundohet që ta mposhtë njeriun. Madhësia e rrezikut fshihet pikërisht këtu.

Përtacia, varësisht nga njeriu dhe koha në të cilën paraqitet, hyn në të gjitha format e mundshme. Ajo e fiton karakterin varësisht nga karakteri dhe sjelljet e njeriut që gjendet përballë. Sinonimet e ndryshme të përtacisë i tregojnë qartë format e saj. Një sinonim i përtacisë është edhe përtimi. Sinonimet tjera janë: indiferenca, mospërfillja, snobizmi, indolenca, denbelizmi, qejfkënaqësia, hutia...! Përtacia nuk shfaqet para çdokujt në të njëjtën formë. Ajo gjithnjë e ndërron rolin si artisti pa punë. Herë merr formën e mikut të sinqertë dhe mirëdashës, herë formën e arsytimit, si sëmundje, lodhje, dhembje e herë duket se bën punë por në të vërtetë nuk punon asgjë, ndërsa herën tjetër flet ëmbël dhe të mashtron. Ajo ka një filozofi mashtruese dhe letërsi demagogjike. Tash dëgjo me vëmendje meqë do të t'i lexoj disa pjesë nga libri i përtacisë:

- Oh mor burrë edhe ti..., çka bëjnë ata që punojnë..? - Mos e dëshpëro veten në këtë botë kalim-

tare, puna është lodhje. – Jeta është një shans. – Nëse ke shans ke çdo gjë. – Nëse nuk ke shans edhe veten në e copëtofs s'ka fajde. Ti e di se edhe ai që e solli ujin edhe ai që e theu shtamën është i njëjti..! – Ti theje shtamën, ujin le ta sjellin të tjerët, kurse ti pi me shëndet..! Nëse një punë duhet të bëhet, edhe në kokë të shpinës në qëndrosh ajo do të bëhet, por nëse nuk do të bëhet, edhe po qe se ndahesh më dysh ajo nuk do të bëhet. – Lëre njëherë, shtrihu, nesër në mëngjes e bën.- Ty puna nuk të bën mirë, të humb oreksi, të shuhet gëzimi. – E kam shprehi, nuk mundem që tërë vitin të endem nëpër biblioteka me libër nën sqetull, çfarë të bëj..! -Njëzet ditë para provimeve do të ulem, do ta lodh kokën dhe tak, do t'i jap provimet. Nuk e di pse mendja vetëm në provim më zgjohet, gjatë vitit jam si në gjumë... Dhe, pse të lodhem, edhe ai i suksesshmi edhe i pasuksesshmi a nuk do të vdesin? - Njeriu njëherë vjen në këtë botë, shiko të jetosh pa brenga në këtë jetë.

Sa e sa gjëra tjera të ngjashme ka në librin e përtacisë. Nuk dëshiroj që të ta lodh kokën me gjërat të cilat edhe vetë i di. Por një gjë do ta them, nëse je përtac dhe përtacia yte nuk është për shkak të ndonjë sëmundjeje organike por vetëm mosvarje e veshit, mospërfillje, indolencë, dembelizëm apo përtim, atëherë me përdorimin e vullnetit mund ta mposhtish këtë armik të suksesit. Por, nëse ke të meta trupore, atëherë këtë duhet ta konsultosh me mjekët.

Armiku tjetër i suksesit është edhe shoku i keq

Miku im i ri! Armiku i dytë i rrezikshëm në rrugën tënde të suksesit është shoku i keq. Ai është fatkeqësia më e madhe që mund ta godasë të riun. Dhe si çdo e keqe, edhe kjo është dinake dhe e maskuar. Maskën e ka të vënduar me shkathtësi të madhe. Përdorë fjalorin e shokut. Tregohet se të ndihmon dhe të mbron. Bën çdo gjë që t'ia keshë lakminë atij. Përtacia është në brendinë tënde dhe të flet me gjuhën tënde, kurse shoku i keq flet me gjuhën e vet dhe më shpejtë të tërheq kah vetja. Në të shumtën e rasteve përtacia paraqitet me pretendimet e shokut të keq dhe kohë pas kohe bëhet shprehi dhe vendoset në brendinë tonë. Shoku i keq ka një filozofi flagrante. Në çdo moment, qoftë nëpërmjet fjalëve qoftë nëpërmjet sjelljeve ta tërheq vëmendjen.

Vëllaçko jetoje rininë, kjo rini nuk vjen edhe njëherë. Njerëzit të cilët të këshillojnë vetë e kanë jetuar rininë dhe tash ta kanë zilinë ty, mos ua var veshin, argëtohu...! - sa e sa gjëra të tjera të thotë.

Shoku i keq shqetësohet prej punëtorëve dhe fshehurazi ua ka zilinë, fillon të tallet me ta dhe t'i nënçmojë e në këtë mënyrë hakmerret ndaj tyre. Mundohet të gjejë mënyrë që me çdo kusht të të tërheqë në greminën në të cilën ka rrëshqitur vetë. Me fjalët dhe sjelljet e veta ta shkatërron energjinë shpirtërore dhe të lë përballë me një lodhje shpirtërore. Thënë shkurt, shoku i keq është fatkeqësia më e madhe që mund ta godasë të riun. Po qe se bashko-hen përtacia dhe shoku i keq, atëherë shumë vështirë

mund të shpëtohet nga kthetrat e këtyre dy armiqve keqbërës.

Dëgjo mirë çfarë të them: Kushtet të cilat do t'i kërkojë te shoku yt duhet të jenë: puna, sinqeriteti dhe mirësia. Njeriu i cili i ka këto cilësi është i stolisur edhe me të gjitha cilësitë tjera të mira. Këtë mos e harro dhe me njerëzit të cilët nuk i plotësojnë këto kushte mos u shoqëro kurrë.

Armiku tjetër i suksesit është shembulli i keq

Në rrugën e suksesit do të hasish edhe një armik, e ai është shembulli i keq. Shembujt e këqij janë parazitë në formë të njeriut të cilët vazhdimisht mundohen t'i pengojnë, t'ua mbyllin sytë njerëzve që kanë arritur pozitë, që kanë famë ose pasuri. Në realitet këta shembuj nuk i kemi vetëm sot, ata kanë ekzistuar në të gjitha epokat. Në çdo kohë ekzistonin njerëz të cilët duke e shfrytëzuar qëllimshëm dhe zemërgjerësinë e të tjerëve i kanë mbushur qeset e veta. Por, sot ata disi u shtuan tepër. Sytë tu të papërvojë në çdo kënd i shohin vetëm këta njerëz. Fatkeqësisht jetës tënde të përkryer të stolisur me punë të përhershme permanente dhe durim të madh, shijen ia humbin këta parazitë.

Si çdo e keqe edhe shembujt e këqij kanë filozofinë e vet e cila shkakton vetëm të liga. Epiqendra e kësaj filozofie është "egocentrizmi", vendosja e vetes në qendër të të gjitha gjallesave dhe të menduarit vetëm për veten. Ndërsa parimi i suksesit është (pa

marrë parasysh në çfarë mënyre) të arrihet absolutja. Në të vërtetë këta janë parazitët më të ligë të botës njerëzore. Dobësitë morale të cilat i theksova më lartë, si p.sh. egocentrizmi, këta njerëz i konsiderojnë si fryte të intelektit dhe në mënyrë jo të ndershme tallen me to, ndërsa arritjen e suksesit nëpërmjet mashtrimit e konsiderojnë sukses më të madh.

Ki kujdes, këta njerëz kurrën e kurrës mos i merr për udhërrëfyes të jetës. Mos lakmo jetën luksoze e të pavlerë të sharllatanllëkut dhe parazitllëkut e assesi mos dysho në rezultatin e sigurt të punës së ndershme, mos e shkatërro fuqinë shpirtërore dhe mos ua lësho ardhmërinë tënde tekeve të një rastësie të errët. Mos lakmo sarajin prej kartuqi të intelektit plot intriga dhe dredhi. Gjithsesi dije që njeriut i cili vërtet është njeri, i ka hije rruga e ndershmërisë dhe drejtësisë.

Ndershmëria do të thotë që njeriu kur të gjendet kokë më kokë me ndërgjegjen e vet, të mos ketë llogari turpëruese që do t'ia japë asaj. Të jeshë i sigurt se ky është kushti parësor i të qenit i lumtur dhe i qetë. Nëse dëshiron të jetosh si njeri i qetë, atëherë këtë qetësi do ta arrish vetëm me drejtësi. Mos harro se thelbi i suksesit është arritja në cak në saje të hapërimit rrugës së drejtësisë dhe ndershmërisë, e assesi nuk do të thotë arritje në pasuri, famë ose pozitë me çfarëdo mjetesh apo në çfarëdo mënyre. Sikur të mos ishte kështu atëherë vjedhësve, vrasësve, shtypësve të cilët nuk arrin t'i kapë policia, do të duhej t'u thuhet se janë njerëzit më të suksesshëm.

* * *

Armiqtë kryesorë dhe tejet të rrezikshëm të cilët do t'i hasish në rrugën e ngritjes dhe suksesit janë të sipërpërmendurit. Në të vërtetë, ndoshta kishte nevojë të të jap disa këshilla edhe në lidhje me librat e dëmshëm dhe profesorët e rrezikshëm. Por kjo nuk është detyra jote por e nëpunësve dhe udhëheqësve të Ministrisë së Arsimit.

Siç thash edhe më parë, ti ke dy armë të forta me të cilat mund t'i luftosh këta armiq: punën dhe vullnetin. Por, me rëndësi është që ta edukosh vullnetin dhe ta njohësh mënyrën frytdhënëse të punës. Sipas meje, dituria më e nevojshme për ty në këtë moment është kjo.

II

Kushtet e suksesit

Lexuesi im i ri! Më lartë t'i prezentova armiqtë të cilët do t'i hasish në rrugën e suksesit, me ç'rast theksova se këta janë përtacia, shoku i keq dhe shembujt e këqij. Në fund ta tërhoqa vëmendjen edhe për librin dhe profesorin e keq. Të thash se në dorë ke dy armë, vullnetin dhe punën, të cilat janë shprehja më e lartë njerëzore dhe etike e vullnetit për t'iu kundërvënë këtyre armiqtë. Tash do ta tregoj mënyrën e përdorimit të këtyre armëve dhe kushtet parësore të suksesit tënd, të familjes, popullit si dhe të mbarë njerëzimit.

* * *

Kushti i parë i suksesit është vullneti

Kushti kryesor si dhe momenti kryesues dhe i parë në jetë është vullneti. Arma e parë para së cilës gjuhëzohen përtacia e mosbindja, këto sëmundje djallëzore, është vullneti. Po qe se vullnetin e përdorësh në rrugën e së mirës, atëherë mos ki frikë. Shoku i keq nuk mund të vendoset në lagjen tënde, goja e të

prishurve nuk do të këndojë përballë teje. ndërsa shembujt e këqij me gjuhën e tyre plot helm nuk do të tallen me ty.

Më duhet ta përsëris edhe një herë se njeriu nuk bëhet njeri me intelektin dhe dijen e tij por me vullnetin. Dije dhe intelekt sadopak kanë edhe kafshët. Por, vetëm vullneti me përmbajtje morale është cilësia e vetme e hallkës së fundit në zinxhirin e krijesave, gjegjësisht njeriut. Vullneti është fuqia shpirtërore që e dallon njeriun jo vetëm nga gjallesat tjera por edhe e ngrit në piadestalin më të lartë në mesin e njerëzve tjerë. Shiko rreth vetes dhe do të shohish se të gjithë njerëzit e ngritur, ngritjen e tyre ia kanë borxh vullnetit të vet. Personalitetet e larta në histori pozitën e tyre e kanë fituar vetëm nëpërmjet vullnetit. Ky është një përkufizim i prerë që nuk duron kurrfarë përjashtimi. Ekzistojnë njerëz të shumtë që nuk kanë shumë dituri, nuk mund të kuptojnë shpejtë ose nuk kanë aspak dituri. Por askund nuk mund të gjesh shembull të së paku një njeriu të suksesshëm që ka vullnet të dobët. Kjo, për arsye se suksesi dhe ngritja janë fryte të mundit, kurse vetë mundi është shprehje e vullnetit.

Nëse mendojmë pak më thellë, vullneti nuk është vetëm kusht i suksesit në pikëpamje materiale dhe shoqërore, por është kushti parësor edhe i lumturisë. Shumica e njerëzve janë në pozitën e Nasradin Hoxhës, i cili ka harruar se është i hipur mbi gomar dhe ka filluar ta kërkojë gomarin nëpër treg. Edhe njerëzit duke harruar se lumturia është në brendinë e tyre, e kërkojnë atë në kafe-bare të natës, kafene dhe në argëtime të ndryshme. Ti mos rrëshqit në këtë

greminë dhe beso se edhe fshehtësia e suksesit edhe zogu i lumturisë janë në brendinë tonë, në kafazin e artë të vullnetit tonë, vullnet i cili është burimi më origjinal i fuqisë njerëzore. Lumturia nuk është thesar si arka e fshehur që mund të zbulohet me një rënie të kazmës. Ajo nuk është as shans, as trashëgim, as lojë e fatit, as pozitë e as pasuri. Lumturia është fortifikatë e cila mund të fitohet vetëm me forcën e vullnetit dhe përpjekjes.

Mendime rreth vullnetit

I respektuari lexues, tani e kuptove rëndësinë e madhe të vullnetit, prandaj lirisht mund të kalojmë në pikat të cilat medoemos duhet t'i dish:

Ç'është vullneti? Çfarë do të thotë të keshë vullnet? A mundet çdokush të ketë vullnet dhe a mundet secili ta përdorë atë? A jemi të lirë dhe të pavarur në vullnetin tonë apo ndoshta jemi të varur nga shkaqet që nuk i kemi në disponim? A mund të bëhemi të vullnetshëm nëpërmjet përpjekjes dhe edukimit? Nëse një gjë e tillë është e mundshme, atëherë cilat janë rrugët për arritjen e saj?

Të pranoj se në këtë moment do të të ballafaqoj me problemet më të rënda dhe më të ndërlikuara të shkencës dhe filozofisë. Do të të lodhë dhe do të të tërheq të mendosh rreth kësaj problematike e cila shekuj me radhë i ka ndeshur filozofët dhe teologët dhe e cila ka qenë shkak i polemikave të shumta. Por, duhet të jeshë i bindur se këto probleme meritojnë që të mendohet dhe lodhet rreth tyre. Po qe se

e vëren, plani i jetës sonë dhe zbulimi i fatit tonë është drejtpërdrejt i varur nga përfundimi që do ta japim pas mendimit rreth këtyre gjërave.

Ne besojmë në fuqinë e madhe të vullnetit dhe në përvetësimin e tij nëpërmjet edukimit të mirë dhe përpjekjes së përhershme? Në këtë rast plani i jetës sonë është ky, përpjekje dhe mund, çdo ditë edhe pak më shumë...! Dalëngadalë e me hapa të sigurt çdo ditë duhet të hapërojmë drejt të mirës dhe ngritjes. Nëse jemi të mendimit se njeriu me mund ose me kthimin e vëmendjes kah vlerat e larta nuk mund ta përvetësojë vullnetin, atëherë rrugë jona do të jetë ose pasimi i epsheve dhe përtacisë ose hidhërimi me fatin dhe pesimizmi. Por, duhet të jemi të sigurt se në të dy rastet fundi i rrugës është i njëjtë – pendim dhe mjerim.

Problemet e sipërpërmendura vërtet janë shumë të rënda dhe gjithsesi janë nyjet më të ndërlikuara të labirintit njerëzor. Por, shoku im i ri mos u dëshpëro, unë nuk dëshiroj të të fus në labirintet metafizike dhe të të shpie në një gjendje në të cilën do ta kërkosh derën nga ke hyrë. Njëkohësisht nuk dëshiroj që me fjalë të kota dhe të tepërta metafizike të ta turbulloj mendjen. Në të vërtetë unë as që kam të drejtë të hyjë në këto diskutime dhe analiza pasi nuk jam as filozof e as spiritualist. Unë jam vetëm një profesor që e ka kaluar rrugën, që e ka ndjerë zbrazëtirën dhe e ka përjetuar torturën të cilën je duke e përjetuar ti. Unë me ty do të flas në këtë cilësi dhe me gojën e metodën e një profesori. Do të kapem dorë për dorë me ty, do të zbres në realitetet jetësore dhe do të futem në mesin e njerëzve. Do t'i analizoj njerëzit

dhe veprat e tyre ndërsa përgjigjen e problemit do ta jap me gjuhën e realiteteve njerëzore.

Ç'është vullneti dhe çfarë do të thotë të kesh vullnet

Për të kuptuar se ç'është vullneti duhet që në mënyrë të përgjithshme t'u qasemi veprave tona, gjegjësisht t'i vëzhgojmë më hollësisht veprat të cilat e mbajnë kontaktin e unit tonë me botën e jashtme. Kjo, për arsye se zotësia shpirtërore e shprehur me fjalën vullnet është forcë që prezentohet përmes veprave dhe lëvizjeve. Pra, atë para së gjithash duhet ta kërkojmë në veprimtarinë tonë dhe medoemos duhet të nxjerrim vendime të larta nga brendia e saj.

* * *

I nderuari lexues! Fort mirë e di se njeriu është i përbërë nga trupi dhe shpirti. Ekzistenca jonë fizike si dhe e të gjitha gjallesave tjera është e varur nga ligjet e përgjithshme të natyrës. Për shembull, edhe ne si trupat tjerë biem poshtë. Si të gjitha krijesat tjera edhe ne jemi nën ndikimin e gjërave të ndryshme, respektivisht, në këtë kontekst jemi një fije kashte që noton në oqeanin e pafund të natyrës.

Por, meqë ne jemi qenie të vetëdijshme që disponojmë me unin tonë, atëherë gjithsesi duhet të dallohemi prej kashtës së thjeshtë: Ne jemi gjallesa të cilat në brendi përmbajnë një thesar të fuqisë misterioze që quhet vetëdije. Njëkohësisht ne jemi

edhe subjektet dhe praktikuesit e një varg veprash dhe lëvizjesh të cilat fuqinë e marrin nga ky thesar. Parafytyro se gjithësia është një det, kurse ne jemi udhëtarët e një anijeje të jetës e cila lundron drejt një vendi të panjohur. Së bashku me anijen e cila tundet nga rënia e valëve edhe ne lëvizim. Së bashku me të, ndonjëri prej nesh hedh thëngjill në koftorët e mëdhenj të anijes, dikush ec me duart e lidhura pas nëpër kuvertën e anijes, dikush është ulur pranë kapitenit dhe e shikon busullën apo drejton timonin..! Gjithsesi e kuptoni se ç'dëshiroj të them. Të gjithë së bashku, me çdo gjë rreth nesh i bashkangjitemi lëvizjes së anijes, por njëkohësisht secili prej nesh bën edhe vepra dhe lëvizje të posaçme. Kështu ndjejmë se lëvizjet tona së bashku me anijen nuk janë tonat, këto janë vepra të faktorëve natyrorë, ndërsa të dytat janë tonat. Praktikues dhe zotërues të tyre jemi ne.

Në realitet nëse mendojmë pak më thellë, do të shohim se edhe veprat e dyta bëhen nëpërmjet dorës së padukshme të fuqisë kreative si ato të parat. Kjo fuqi absolute e cila e tundë anijen dhe na shëtiti nëpër kuvertën e saj, herë na bën të qeshim e herë të qajmë. Në daç thuaj Zot, në daç Dieu, është po e njëjta fuqi, me një dallim të vogël, ashtu që kjo fuqi pa fillim dhe pa mbarim në veprat të cilat i konsiderojmë si tonat, ndikon jo në mënyrë të drejtpërdrejtë por nëpërmjet unit tonë. Kurse ndërmjet veprës dhe vepruesit paraqitemi ne si krijesa e tretë. Ajo fuqi e amshueshme na lë të lirë në lëvizjet dhe punët tona. Cila është kjo fuqi? Për këtë mos më pyet:

“Nuk e zgjidhi sekretin e këtij labirinti askush, me mijëra karvanë dijetarësh e të shkathët kaluan më huq.”

* * *

Lëvizjet tona dhe ato që nuk janë tonat

Dëshiroj të them se ne jemi qendër e dy llojeve të lëvizjes. Disa nga lëvizjet janë tonat ndërsa disa nuk janë. Le t'i kalojmë të parat ndërsa t'i analizojmë lëvizjet që nuk janë tonat. Vullnetin duhet ta kërkojmë pikërisht në këto lëvizje. Por, pikësëpari këtë pyetje duhet t'ia parashtrojmë vetes: Lëvizjet të cilat parimin e tyre e gjejnë në qenien tonë a thua vërtet janë tonat? Gjegjesisht, a paraqiten me mendimin dhe vetëdijen tonë. Nëse mendojmë mirë, do të themi jo. Shikoni, p.sh., kur u lindëm ne ishim një krijesë shumë e vogël. Gjatë viteve u rritëm dhe u zhvilluam. Kjo lëvizje e zhvillimit dhe rritjes pasi që paraqitet në strukturën tonë trupore është e jona, por nuk është fryt i vetëdijes sonë. Lëvizjet muskulore, gjegjesisht reflekset të cilat paraqesin themelin biologjik të jetës sonë dhe të cilat parimin e përhapjes e marrin nga thesari ynë jetësor në shikim të parë janë tonat por, ato paraqiten jashtë vetëdijes sonë. E dimë shumë mirë se qendra kryesore e reflekseve tona të brendshme është zemra. A jemi diç të informuar në lidhje me atë se çka hyn dhe del nga kjo banesë tejet e zellshme e shpirtit tonë?

Reflekset dhe lëvizjet automatike

Pra, të përsërisim se prej kapitullit të vullnetit përveç lëvizjeve të cilat nuk janë tonat duhet të nxjerrim edhe një pjesë prej lëvizjeve të cilat janë tonat: Duhet t'i kapërcejmë veprimet organike të cilat paraqiten në thellësitë e jetës sonë fiziologjike pa vetëdijen tonë. Madje, nevojitet që t'i lëmë anash edhe lëvizjet automatike të cilat përbëjnë pjesën e sipërme të jetës sonë dhe të cilat burimin e përhapjes e kanë në energjinë tonë shpirtërore. Kini kujdes, lëvizjet automatike dallojnë nga reflekset. Reflekset janë në varshmëri të ngushtë me jetën tonë bimore kurse ato automatike janë vepra të jetës sonë shtazore. Por edhe pse këto të dytat fort pak dallojnë nga reflekset, përsëri edhe ato si reflekset paraqiten jashtë vetëdijes sonë. Këto lëvizje automatike të cilat kaplojnë një pjesë të madhe të jetës sonë por janë të huaja për vullnetin paraqiten në tri forma, edhe atë: instinktët, shprehitë dhe sugjerimet.

Lëvizjet instinktive

Instinktët të cilat përbëjnë një pjesë të madhe të jetës shtazore, janë dukshëm të pranishme edhe në jetën e njeriut. Ne nuk e dimë ashtu si duhet se çka janë instinktët në të vërtetë, por e dimë se instinkti është një fuqi e errët e cila gjithnjë paraqitet në të njëjtën mënyrë, është e pranishme që nga lindja dhe paraqitet si shprehje e një animi ose e një nevoje të posaçme.

Shikoni bletët të cilat jetojnë në zgjojet e tyre. Këto gjallesa edhe sot jetojnë në të njëjtën mënyrë siç kanë jetuar mijëra vjet më parë, pa marrë parasysh vendin e jetesës. Ato gjithashtu në të njëjtën mënyrë e prodhojnë mjaltin. Dora e fuqisë absolute i ka krijuar bletët në atë mënyrë që prej fillimit deri në fund të krijohen dhe jetojnë si artiste të shquara. Ja pra, ky është instinkti.

Në shikim të parë lëvizjet instinktive duken si prodhim i arsyes dhe vullnetit. Nëse nga larg e shikojmë zogun i cili bën folenë, lejlekun duke i mësuar të vegjëlit e vet të fluturojnë, merimangën duke e pritur ushqimin në rrjetën e vet, nënën e cila e vë në rrezik jetën e vet për ta shpëtuar fëmijën, do të mendojmë se në këto lëvizje ka gjurmë të vetëdijes. Por ky observim është mashtrues. Në të vërtetë këto lëvizje janë specifike vetëm për zogun, merimangën dhe nënën dhe janë lëvizje të nxitura nga bashkangjitja e disa reflekseve në shoqërim të ndikimit shpirtëror.

Shprehitë

Një pjesë e madhe e lëvizjeve tona automatike paraqiten në formë të shprehive. Shprehitë të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në rrugën e suksesit rrënjësisht dallohen nga instinktet. Instinktet, siç u tha më lartë, janë specifike vetëm për llojin e vet, kurse shprehitë janë specifike e individit. Megjithatë ato dallohen prej individit në individ, madje disa herë dallohen edhe në fazat e ndryshme të evoluimit jetësor të njeriut të njëjtë. Përderisa instinktet trashë-

gohen si një nevojë prej llojit në individin, shprehite kryesisht mësohen më vonë dhe nga rrethi i jashtëm. Në të shumtën e rasteve ato paraqiten si shprehje e animi apo nevojës së posaçme. Herë si imitim e herë me arsye, shprehite duke u përsëritur vendosen dhe e humbin vetëdijen kështu që bëhen automatike. Për shembull të vegjëlit nëse i shohin të mëdhenjtë duke i fryrë hundët dhe duke pështyer djathtas e majtas, do të veprojnë në po atë mënyrë. Pas disa përsëritjeve kjo sjellje e shëmtuar bëhet shprehi edhe e tyre. Së pari ndezim një apo dy cigare anash..., më vonë edhe dy-tri në shoqëri kështu që mësohemi me pirjen e duhanit dhe kjo na bëhet shprehi. Të gjitha shprehite e shëmtuara si alkooli, bixhozi, gënjeshtër fillojnë në këtë mënyrë dhe në fund përfundojnë me një dështim të plotë. Edhe mekanizmi psikologjik i shprehive njëlloj si i instinkteve paraqitet me bashkimin e disa reflekseve dhe në bazë të ndonjë ngacmimi. Duhet ta theksojmë edhe atë se nevoja ose animi i paraqitjes së shprehive shpeshherë krijohen dhe në këtë pikë ato dallojnë nga instinktët. Përderisa instinktët në përgjithësi e paraqesin nevojën ose animin e një organi, shprehite shpeshherë paraqiten si rezultat i një tradite, kurse disa herë edhe si prodhim i mendimit dhe kohë pas kohe marrin formën e nevojës. Për njeriun i cili nuk e ka bërë shprehi duhanin, alkoolin dhe bixhozin ato asesi nuk paraqesin nevojë. Por nëse këto vese të liga fillojnë t'i bëhen shprehi, atëherë edhe ndaj tyre fillon të ndjejë nevojë sikur që ndjenë ndaj bukës dhe ujit. Respektivisht, fillimi i instinkteve është lindja kurse i shprehive, hera e parë e vargut të lëvizjeve të cilat përsëriten.

Pikërisht kjo lëvizje e parë është tejet e rëndësishme. Njeriu duhanin e konsumon me një cigare ndërsa alkoolin me një gotë. Pikërisht për këtë themi se ndryshimi ose përmirësimi i instinkteve s'është i pamundshëm, por gjithsesi është shumë i vështirë. Është normale që prej nënës nuk mund të fshihet dashuria dhe mëshira ndaj fëmijës së vet. Macja nuk e ndryshon instinktin e zënies së minjve. Gjithashtu edhe ndryshimi i shprehive tona nëpërmjet edukimit të unit tonë ose largimi prej tyre, që në fillim është në duart tona. Është tejet me vend proverbi popullor "shprehia është më e keqe se hutia", por gjithnjë është e mundshme që të shlyhen veset e liga dhe të përvetësohen shprehitë e mira që na e hapin rrugën e suksesit. Meqë një gjë e tillë është e mundshme, pikërisht shkollat janë të obliguara që të rinjve, fatin e të cilëve e kanë në dorë, t'u mbjellin shprehi të mira nëpërmjet të cilave do të arrijnë sukses e lumturi dhe t'i ruajnë nga shprehitë e shëmtuara.

Sugjerimet

Një lloj tjetër i lëvizjeve që paraqiten jashtë vullnetit tonë janë edhe lëvizjet të cilat i bëjmë me sugjerim nga jashtë. Nëse i vemi re, edhe këto si instinkt dhe shprehitë edhe pse bëhen nga ana jonë, në realitet nuk janë tonat.

Sugjerim është fjala ose vepra e cila na lë në ndikim dhe në bazë të këtij ndikimi duke e përfituar besimin tonë na bën të kryejmë një vepër të caktuar. Ky ndikim mund të jetë për punë të liga por edhe për

të mira. Për fat të keq, ky lloj i lëvizjeve posaçërisht është i pranishëm te të rinjtë. Ndikimin të cilin mund ta bëjnë lëvizjet, sjelljet dhe fjalët e një shoku të keq, nuk mund ta bëjnë as mijëra e mijëra këshilla të mira.

Shihet qartë se organizmi ynë është epiqendra e përhapjes së shumë veprave dhe lëvizjeve. Disa prej këtyre si rritja dhe zhvillimi janë të natyrës bimore ndërkaq disa të tjera janë organike dhe automatike, gjegjësisht të natyrës shtazore. Këto lëvizje, të cilat në shikim të parë duken si tonat, në të vërtetë nuk janë tonat, për arsye se ato nuk janë vepër e vullnetit dhe vetëdijes sonë.

Lëvizjet e vetëdijshme dhe vullneti

Përveç lëvizjeve tona të natyrës bimore dhe shtazore kemi edhe një grup të lëvizjeve të cilat vërtet janë tonat dhe janë shprehje e ekzistencës sonë njerëzore, respektivisht janë pronë origjinale e jona. Këto vepra të vetëdijshme aplikohen vetëm pasi të filtrohen në dritën e vetëdijes dhe të maten në peshojën mendore. Kjo është zotësia shpirtërore dhe energjia metafizike të cilës ne i themi vullnet, gjegjësisht fuqia e nxjerrjes në shesh të gjërave të vendosura në brendinë tonë dhe sjellje e tyre deri në fazën e realizimit.

Këtë problematikë do ta sqaroj me një shembull mendor: Lexues i nderuar! Paramendo se një ditë ke dalë nga fakulteti për të ngrënë drekë. Pasi e ke ngrënë drekën, je nisur për në bibliotekë por në një

kafene rreth rrugës i sheh disa shokë të afërt të cilët luajnë tabell. Përnjëherë të gjithë i ngrenë duart dhe të thërrasin. Në shikim të parë dëshiron të shkosh dhe i ngadalëson hapat..., sikur natyra plot shamatë e kafenesë, zëri i gurëve të lojës, shakatë e të rinjve t'i vënë zinxhirët dhe të tërheqin drejt tyre. Kjo thirrje, ide dhe sugjerim ndoshta e nxitë fuqinë tërheqëse të shprehisë për ta luajtur këtë lojë dhe vjen deri në atë pozitë që të mos shkosh fare në bibliotekë... por, përnjëherë ndër mend të kalon si vetëtimë një përfundim, dhe me një vendosmëri momentale përgjigjesh se duhet të shkosh në bibliotekë dhe e vazhdon rrugën. Ja pra, shoku im i ri, me këtë vendosmëri ti e përdore mendjen dhe vullnetin në rrugën e suksesit dhe mirësisë. Iu kundërvure zvarritjes automatike të shprehisë dhe sugjerimit.

Vullneti etik

Nëse e përsërisim do të themi se vullneti është fuqia për vendosje pas të menduarit dhe zgjedhje e pëlqim i njerit nga disa veprimet e mundshme në një moment të caktuar. Por këtu të ndalemi pak. Vrojtimet e përditshme na dëshmojnë se njeriu këtë fuqi ashtu siç mund ta përdorë për të mirë, njëlloj e përdorë edhe për të keq. Dhe ka mundësi ta zgjedhë të keqen. Të parafytyrojmë një njeri bujar i cili i ndihmon të varfërit dhe një vrasës i cili pa kurrfarë mëshirë e vret njeriun. Është e qartë se që të dy mendojnë dhe vendosin dhe veprimin e tyre e bëjnë me vetëdije. Por këtu ekziston një dallim i vogël, meqë

njëri e përdorë mendjen dhe fuqinë ekzekutive të vullnetit për të mirë kurse tjetri për të keq. I pari vepron sipas animeve njerëzore dhe etike në brendi kurse i dyti sipas pasioneve dhe animeve shtazore në të.

Prandaj në tematikën e suksesshmërisë vullnetin nuk duhet ta konsiderojmë si fuqi shpirtërore të verbër dhe absolute, por duhet ta marrim parasysh në pikëpamje etike si vendosmëri e mendjes në rrugë të së mirës dhe në zgjedhje të veprave dhe lëvizjeve të preferuara, ndërsa paraqitjes së këtillë të vullnetit ne i themi vullnet etik. Pra, të jeshë i vullnetshëm në këtë pikëpamje do të thotë të jeshë zotërues i fuqisë shpirtërore e cila do të të mundësojë zgjedhjen dhe realizimin e veprave të mira dhe largimin nga robëria e shembujve, shprehive dhe sugjerimeve të shëmtuara. A thua mund të bëhemi të këtillë? A është vullneti në duart tona? A jemi të lirë në pëlqimin, udhëheqjen dhe kontrollimin e lëvizjeve tona? Ky problem a është problem i edukatës, apo rezultat i krijimit? Nëse është rezultat i krijimit, atëherë munda mendor dhe shpirtëror a nuk ka kurrfarë ndikimi në karakterin tonë? Me këto pyetje i afrohem pikës kryesore të temës sonë.

III

Ndikimi i edukatës në shpirtin dhe karakterin njerëzor

Natyra dhe karakteri

I nderuari lexues! E ke të njohur se njerëzit dallojnë nga njëri-tjetri sipas ndërtimit trupor, strukturës fiziologjike dhe organike, ngjyrës së syve dhe të lëkurës etj. Nëse në një vend ku ka rrëmujë njerëzish, si për shembull në stadium shikojmë fizionominë e njerëzve, do të shohim se asnjëri nuk i ngjason tjetrit. Në tërë sipërfaqen e tokës nuk mund të gjejmë dy njerëz të cilët krejtësisht i ngjasojnë njëri-tjetrit. Mjekët madje nuk hasin në sëmundje dhe reagime plotësisht identike të të gjithë të sëmurit. Fuqia krijuese që nga fillimi i njerëzimit ka krijuar tipe të ndryshme prej njëri-tjetrit dhe sipas modeleve jo-identike. Çdo njeri me strukturën e vet organike dhe dallimet trupore paraqet një kozmos në vete dhe është një tip biologjik i posaçëm. Struktura trupore e çdo individi dhe specifikat organike të tij prodhojnë një komponentë që ne e emërojmë si natyrë ose temperament.

Njerëzit nuk dallohen nga njëri-tjetri vetëm sipas strukturës trupore, fizionomisë dhe natyrës por njëkohësisht dallohen edhe në bazë të ndërtimit dhe reagimeve shpirtërore. Dallimi i këtillë është më i rëndësishëm dhe më bazor. Askund nuk mund të gjenden dy njerëz të cilët reagojnë në mënyrë të njëjtë rreth një ngjarjeje, ose kanë botëkuptim dhe koncept të njëjtë. Çdo njeri me strukturën specifike dhe cilësitë shpirtërore të tij paraqet një botë dhe personalitet psikologjik të posaçëm. Struktura metafizike e individit dhe specifikat shpirtërore të tij prezentojnë një formë të veprimit që ne e quajmë karakter.

Kuptimet e fjalës karakter

Me termin karakter në shikim të parë nënkuptohen specifikat dhe dallimet shpirtërore të cilat e dallojnë një njeri nga të tjerët. Specifikat shpirtërore të individit paraqesin një botëkuptim të caktuar dhe herë pas here paraqiten si reagim i caktuar ndaj një ngjarjeje. Thënë shkurt, specifikat shpirtërore të çdo njeriu krijojnë një personalitet metafizik dhe fizionomi shpirtërore të posaçme. Me një fjalë, karakteri është shprehje e këtij personaliteti dhe fizionomie.

Fjalët karakter dhe ves përdoren në të njëjtin kuptim edhe për grupe të njerëzve edhe për popuj të caktuar. Kur përdoren për grup të caktuar i prezentojnë cilësitë shpirtërore të grupit gjegjës. Kur themi karakteri i turqve apo shqiptarëve, këtu nënkuptohen trimëria dhe altruizmi si cilësi të përbashkëta të secilit nga këta dy popuj.

Thënë shkurt, shprehja karakter do të thotë personalitet i formuar, vullnet i edukuar, vetëdije e zgjuar, posedues i mendimeve, lëvizjeve dhe parimeve të qëlluara. Njeriu me karakter është njeri me personalitet, parime, me vetëdije dhe vullnet. Njeriu pa karakter është njeri pa personalitet, i pabesë, pa rezon, me një fjalë njeri i pështjelluar. Nga një pikëpamje tjetër njeri me karakter është njeriu i cili lirohet nga kthetrat e instinkteve dhe pasioneve shtazarake. Nëse e vëmë re, ky kuptim i karakterit paraqet qëllimin e përkryer dhe më të lartë të edukatës dhe moralit. Në të vërtetë, qëllimi parësor i etikës është formimi i njeriut me karakter dhe temperament të sigurt. Më duhet të theksoj edhe atë se në këtë broshurë shprehjen karakter herë do ta përdorim në kuptim të vesit, e herë në kuptim të temperamentit.

* * *

Njerëzit kanë karaktere dhe natyra të ndryshme

Njerëzit siç dallohen në pikëpamje të fizionomisë dhe ndërtimit trupor ata gjithashtu dallohen edhe në pikëpamje të specifikave shpirtërore, fizionomisë metafizike, respektivisht dallohen në pikëpamje të veseve. Disa njerëz shpejtë bien nën ndikimin e huaj, entuziazmohen, hidhërohen dhe i kaplon frika ndërsa disa tërhiqen në vete dhe jetojnë me ndjenjat dhe mendimet e veta. Këta të dytët pasionet dhe dhimbjet i përjetojnë rëndë. Disa janë mjaft të zgju-

ar, të shkathët e guximtarë dhe atyre nuk u pëlqen meditimi dhe thellimi në vetvete. Përkundrazi, dëshirojnë që jetën ta kalojnë në lëvizje e veprim. Këta gjithmonë janë të gëzuar, optimistë, ndërsa shpirti i tyre është përplot shpresë e veprim. Këta njerëz janë tejet realë dhe praktikë; shpejtë vendosin dhe dëshirojnë që sa më shpejtë t'i realizojnë vendimet e tyre. Disa njerëz janë më të rëndë dhe përtacë, të pasigurt, të pavendosur, bëjnë llogari të shumta dhe tërhiqen në vete. Ata mendojnë dhe analizojnë shumë por tejet pak veprojnë. Të tillët sikur frikohen nga iniciativa, ndjejnë kënaqësi nga meditimi dhe puna mendore, më tepër dëshirojnë të jetojnë në botën e mendimeve dhe t'i shmangen realitetit. Ata në të shumtën e rasteve janë pesimistë dhe plot brenga. Thënë shkurt, disa njerëz janë tepër të ndijshëm e romantikë, disa janë aktivë, realistë dhe të dobishëm, kurse disa të tjerë janë apatikë dhe të rëndë.

A ndryshon karakteri? Problemi qëndron këtu: A ka mundësi që specifikat shpirtërore të një personi të caktuar të ndërrohen në përgjithësi apo pjesërisht, a është e mundshme që atë ta largojmë nga veset e shëmtuara dhe ta pajisim me të bukura ose së paku t'ia përmirësojmë ato të shëmtuarat dhe në këtë mënyrë të vendoset një baraspeshë ndërmjet këtyre fuqive, respektivisht a ka mundësi që një njeri tepër romantik dhe të ndijshëm ta bëjmë aktiv dhe realist?

Dy interpretime dhe dy përgjigje

Në historinë e të menduarit për këtë pyetje janë dhënë dy përgjigje. Njëra prej tyre është optimiste dhe pozitive kurse tjetra pesimiste dhe negative dhe që të dyja thonë se veset janë të lindura. Njeriu lindet bashk me veset e mira dhe të liga; nga të mirat ka dobi kurse të ligat gjatë tërë jetës i bart në shpinë si barrë e rëndë. Meqë karakteri dhe natyra e njeriut janë shprehje të përhershme të krijimtarisë trupore dhe specifikave organike, ashtu edhe veset janë shprehje e ndërtimit shpirtëror dhe strukturës metafizike dhe nuk pranojnë kurrfarë përmirësime.

Teza mbi atë se edukata nuk luan rol të rëndësishëm në karakterin dhe shpirtin

Sipas kësaj teorie njeriu pasiv nuk mund të bëhet aktiv, përtaci nuk mund të bëhet punëtor, frikacak nuk bëhet dot guximtar, ndërkaq koprraci asesi nuk bëhet bujar. Njeriun e mjerë dhe me vullnet të dobët nuk mund ta shndërroni në njeri punëtor e të zellshëm. Po ashtu edhe njeriun e vrazhdë nuk mund ta bëni të mëshirshëm. Nuk keni mundësi që prej kryelartit, ziliqarit, të mjerit, gënjeshtarit, mashtruesit, egoistit t'i shlyeni këto vese të liga. Në këtë pikëpamje edhe feja edhe dituria edhe edukata mbeten pa tekst. Në të vërtetë kështu edhe ka ndodhë. Shekuj me radhë feja, dituria dhe edukata sugjerojnë të mirën, kurse sot shumica e njerëzve janë të pamë-

shirshëm, të vrazhdë, egoistë, gënjeshtarë, të pander-
shëm dhe assesi nuk mund të shpëtojnë nga këto ve-
se të liga, për arsye se vesi dhe natyra janë të njëj-
ta. Vesi i një njeriu është karakteristika e tij materia-
le. Ne kemi mundësi që ta ndryshojmë materien, por
nuk kemi mundësi ta ndryshojmë natyrën e saj. Një
cope hekuri me ndihmën e teknologjisë mund t'ia
ndryshoni formën, mund ta bëni çelik, por assesi nuk
kemi mundësi që ta ndryshoni natyrën e hekurit dhe
atë ta shndërroni në ar. Hekuri gjithmonë është he-
kur, ndërsa ari është ar. Një egërsirë mund ta zbutni
dhe ta bëni shtëpiake, por assesi nuk kemi mundësi
që macen ta largoni nga zënia e miut, qenin nga
lëpirja e eshtrave. Bleta thumbon ndërsa ujku copë-
ton. Thumbimi dhe copëtimi janë në natyrën e këtyre
krijesave.

Dituria dhe edukata nuk i ndërrojnë veset por
vetëm i mbulojnë. Njeriun me vese të këqija nëpër-
mjet fesë dhe etikës, nëpërmjet përvojave shkencore
dhe edukative mund ta drejtosh nga e mira dhe mund
t'i hedhish një mbulesë mbi veset e këqija. Megjitha-
të atë nuk mund ta ndryshoni dhe një njeri të ligë
nuk kemi mundësi ta nxirni nga kthetrat e së keqes.
Veset të cilat mendoni se i keni ndryshuar nëpërmjet
edukimit, në momente të caktuara mund të paraqiten
në formën më të shëmtuar. Veset e këqija të cilat janë
të edukuara u ngjasojnë çibanëve, maja e të cilëve
është tharë por trupi i tyre ekziston nën lëkurë. Këta
çibanë presin vetëm një fërkim që të pëlcasin. Sa e
sa njerëz të ditur, humanë e tepër të kujdesshëm, me
uniformë, mund t'i shohësh që në momente të caktu-
ara mund të shprehin të liga të papritura, për arsye se

veshmbathja, uniforma, janë perde të lëshuara përpara syve. Pedantëria e tepërt është vetëm maskë për mbulimin e thelbit të prishur. Pedantëria e tepërt te njeriu i prishur është si llaku. Është si ngjyra mbi qelq. Ajo mbetet në sipërfaqe dhe assesi nuk zbret në bërthamë e në thelb. Njeriu i mirë nuk njihet sipas stofit sipërfaqësor të edukatës por sipas bërthamës së pastër. Gjegjësisht, edukata e mbulon vetëm vesin e keq dhe e fsheh fizionominë e brendshme të njeriut. “Por vesi asnjëherë nuk ndryshon”. “Edhe po qe se i vëndon shalë, gomari është gomar”. Siç thotë edhe Shejh Sadiu: “Këlyshi i ujkut edhe po qe se rritet në mesin e njerëzve, ai përsëri mbetet ujk”.

Edhe populli edhe mendja e shëndoshë e njeriut kështu mendojnë për këtë problematikë. Fjalët e urta popullore si: “Vesi është nën shpirtin”, “Pa mos dalë shpirti nuk del as vesi”, janë shprehje e këtij realiteti. Sipas botëkuptimit popullor edukata u ngjason mëlmesave që i shtohen gjellës. Ato njeriut i mundësojnë një shije të jashtme, por assesi nuk e ndryshojnë thelbin e tij. Përfaqësues të këtij mendimi në shekujt e fundit janë filozofi holandez Shopenhaueri, Kanti, Stjuart Milli, Spenseri etj.¹⁴ Kohëve të fundit edhe disa sociologë si Gustav le Boni, duke u nisur nga ky interpretim kanë pohuar se çdo popull ka karakterin e vet dhe se këtë karakter nuk e ndryshojnë dituria dhe qytetërimi.

¹⁴ Kanti: filozof i madh gjerman, 1724-1804; Jahn Stjuart Mill: filozof anglez, 1806-1873; Herbert Spenser: filozof anglez, 1820-1903.

Interpretimi pozitiv

Sipas interpretimit tjetër i cili në përgjithësi është i kundërt me këtë që e përmendëm, veset tona të mira ose të këqija nuk janë të lindura, por janë të fituara. Njeriu lindet i pastër nga çdo ves, ide ose ndjenjë, por është i përshtatshëm për ta pranuar çdonjërin prej tyre. Edhe veset si mendimet dhe ndjenjat i përvetësojmë nga rrethi në të cilin jetojmë. Njeriu lindet dhe jeton në një rreth, klimë dhe kushte të caktuara. Sipas ndikimit të këtyre kushteve dhe në bazë të edukatës që ka ai edhe e përfiton fizionominë shpirtërore. Por kjo fizionomi nuk është në formë të shkëmbit, i cili njëherë është formuar dhe më nuk ndryshon. Përkundrazi, ajo gjithmonë ka mundësi të ndryshojë dhe të ndryshohet, për arsye se njeriu ka vullnet të lirë dhe me këtë fuqi ka mundësi ta kontrollojë dhe udhëheq vetveten. Ekzistimi i moralit dhe edukatës që nga kohët e hershme është argument më i mirë se këto vlera ndikojnë në veset dhe se të njëjtat mund të ndryshojnë nëpërmjet tyre. Sikur edukata dhe morali të mos kishin kurrfarë ndikimi mbi veset, me mijëra njerëz në histori nuk do t'i shfrytëzonin këto disiplina. Ndikimi i dobët i moralit dhe edukatës mbi veset e njerëzve qëndron që nga kohët më të lashta, për shkak se ato nuk janë praktikuar në kushte dhe forma të duhura dhe për shkak se ende nuk njihen sa duhet mekanizmat shpirtërorë të njeriut.

Është e vërtetë se veset e përvetësuara në rini e posaçërisht në fëmijëri rrënjosen thellë dhe më vonë gjithnjë e më tepër u kundërvihen vullnetit dhe edukatës, për arsye se rinia si në formën fizike ashtu

edhe në atë metafizike është periudha më e ndieshme e njeriut. Nga ana tjetër, veset e përvetësuara në rinia më vonë plotësohen me përtacinë dhe mosinteresimin dhe si të tilla vazhdojnë deri në vdekje. Pikërisht për këtë themi se periudha më frytdhënëse e ndikimit të moralit është rinia. Edhe pse rinia përballlet me kundërvënie të shumta, prapëseprapë me ndihmën e vullnetit dhe përpjekjeve të ndryshme edhe veset më të shëmtuara mund të çrrënjosen. Ky botëkuptim i cili nuk është aq i afërt me racionalizmin e shekullit tonë, është prezentuar në shekullin XVIII ndërsa përfaqësues kryesor i tij është J.J. Rousseau. Ky filozof në veprat e tij “Marrëveshja shoqërore” dhe “Emili” me të madhe e mbron këtë teori.¹⁵

Siç shihet, njëra nga teoritë të cilat flasin për ndikimin e edukatës mbi shpirtin dhe karakterin është e errët dhe pesimiste, kurse tjetra është tejet optimiste, meqë pohon se një edukatë e vetëdijshme mund të luajë rol të rëndësishëm në përmirësimin e veseve të njeriut.

* * *

Fatalizmi dhe fatalistët në pedagogji (edukatë)

Të shtojmë edhe atë se kjo problematikë me të madhe është shqyrtuar edhe në filozofinë fetare, e

¹⁵ Jean Jacques Rousseau, filozof dhe pedagog francez, 1712-1787.

veçanërisht mendimtarët e botës islame mjaft i janë kundërvënë njëri-tjetrit në të. Në periudhën e Halifatit abbasit u paraqit një drejtim fatalist i cili në historinë e mendimit islam njihet si Xhebrijje. Përderisa Ehli Sunneti besonte në lirinë e vullnetit dhe ndikimin evident të edukatës dhe moralit mbi shpirtin, xhebrijtë u zhytën në fatalizëm të thellë dhe njeriun e konsideronin si lodër në duart e vullnetit dhe fuqisë hyjnore. Sipas tyre punët e njeriut që më parë janë të vendosura dhe të shkruara në Levhi Mahfudh*, gjegjësisht në botën e shpirtit. Çdokush në këtë botë vjen me një letër në dorë në të cilën janë shkruar fati dhe caktimi i tij. Veprimtaria e secilit varet nga caktimi i tij. Askush nuk del jashtë kësaj dhe askush nuk ka mundësi ta ndryshojë atë. Çfarë duhet të bëhet do të bëhet, nëse duhet të të dalë syri ai do të dalë. Gjaku i cili duhet të rrjedhë nuk qëndron në damarë. Njeriu me vese të shëmtuara si lindet ashtu edhe vdes. Ky është caktimi i tij. Askush nuk mund t'i kundërvihet vendimit të letrës së caktimit. Çfarëdo që të bësh është e kotë. Përpjekja për gjetje të rrugëdaljes është vetëm lodhje e asgjë tjetër.

Teoria fataliste assesi nuk mund të mbrohet. Nuk shoh kurrfarë nevoje që të ndalem më tepër mbi këtë teori, meqë është larg determinizmit shkencor dhe prezenton varfërinë dhe mjerimin. Mosqëndrueshmëria dhe gabueshmëria e kësaj teorie është e qartë dhe as që duhet të diskutohet për të. Por, me doemos më duhet të theksoj se kjo teori nuk i takon filozofisë origjinale islame. Feja islame, siç është prezentuar në drejtimin e Ehli Sunnetit, është fe e

* Libër i ruajtur

lartë e cila e pranon lirinë e vullnetit si dhe e proklammon dhe sugjeron ndikimin e moralit dhe të edukatës në veset e njeriut.

Nëse i largohemi kësaj teorie fataliste, atëherë cila prej të parave është e drejtë. Me këtë rast menjëherë duhet të përgjigjemi, se po qe se analizohen ashtu si duhet asnjëra prej tyre nuk është plotësisht e drejtë. Megjithatë, që të dyja disponojnë me anët e tyre të vërteta.

***Disa vese kemi mundësi
t'i përmirësojmë
kurse disa të tjera assesi***

Sipas mendimit tonë, disa vese nuk kemi mundësi t'i përmirësojmë meqë janë të thelluara në shpirtin dhe thellësitë e unit biologjik të njeriut. Dora e edukatës, moralit dhe diturisë nuk mund të arrijë në këto thellësi. Megjithatë disa nga veset tona kemi mundësi t'i përmirësojmë, t'i ndryshojmë me ndihmën e një edukate të fortë dhe vendin e tyre ta plotësojmë me virtyte të mira. Gjithashtu ekzistojnë edhe vese të tilla të cilat pa përpjekje të mëdha mund të përmirësohen dhe të fitojnë fizionomi të bukur. Pra, problemi qëndron në përcaktimin e asaj se cilat vese nuk kanë mundësi të ndryshohen dhe përmirësohen, e cilat nëpërmjet edukatës dhe moralit të fortë kanë mundësi të përmirësohen. Për ta përcaktuar këtë me-
doemos duhet ta gjejmë burimin e veseve tona.

Duhet të jemi të kujdesshëm në atë se çdo ves yni, i mirë ose i keq, është paraqitur në kohë të caktuar, në bazë të faktorëve të ndryshëm dhe në strukturë të caktuar, prandaj duhet të mendojmë rreth faktorëve të sipërpërmendur të cilët janë evidentë në ndikimin mbi një ves të caktuar. Veset tona nuk janë çështje të dala nga një burim i njëjtë e as nuk janë fryt i faktorëve të njëjtë. Përkundrazi, veset tona kanë burime të ndryshme dhe faktorë të ndryshëm. Cilët janë këta faktorë?

Trashëgimia dhe veset e trashëguara

Njëri ndër faktorët më të rëndësishëm i cili i gatuan veset tona gjithsesi është trashëgimia. Edhe veset, si disa sëmundje, rrënjët i kanë në familjen dhe trashëgiminë. Disa vese tona herë si arkë e begative e herë si kallëp i mëkateve trashëgohen prej të parëve. Shumicën e veseve të mira e kemi të huazuar prej prindërve por edhe përgjegjësia e shumë veseve tona të këqija është e prindërve tanë. Por, ç'është trashëgimia përmes së cilës veset përcillen nga brezi në brez? Këtë çështje as shkenca ende nuk ka arritur ta sqarojë sa duhet. Ajo që e dimë është se si në fizikën ashtu edhe në metafizikën e njerëzve ekzistojnë gjurmë prej të parëve të tyre.

Veset e trashëguara nuk mund t'i ndryshojmë

Veset e trashëguara nuk kemi mundësi t'i ndryshojmë. Në këto vese nuk mund të ndikojnë as dituria, as qytetërimi, as edukata e as morali. Këto janë në shpirtin tonë dhe janë brum biologjik yni. Veset e mira të trashëguara gjatë tërë jetës na shërbejnë për të mirë, kurse të këqijat jemi të detyruar që gjatë tërë jetës t'i bartim mbi shpinë dhe ato na përcjellin deri në vdekje.

Veset e natyrës njerëzore

Nëse shikojmë pak më me vëmendje do të shohim se një pjesë e veseve tona burimin e kanë në natyrën dhe temperamentin tonë. Megjithatë të gjitha veset nuk janë të trashëguara meqë një pjesë e tyre buron nga natyra, gjegjësisht nga ndërtimi ynë organik. Mjekët dhe filozofët e vjetër i kanë kushtuar rëndësi të madhe këtij problemi. Në filozofinë e vjetër veset janë konsideruar si pjesë përbërëse të organizmit të njeriut dhe si një lloj i natyrës së njeriut. Në filozofinë e vjetër ekziston edhe një teori e cila e sqaron raportin midis natyrës dhe veseve. Kjo teori e cila deri vonë ishte në plan të parë, e madje edhe sot e kësaj dite është me vlerë, thotë se gjithësia është e përbërë prej katër elementeve kryesore ("anasiri erba'a"): ujit, zjarrit, ajrit dhe dheut. Edhe njeriu si pjesë e gjithësisë është i përbërë prej katër elementeve. Këto elemente janë: gjaku, limfa, nervat

dhe vreri. Varësisht nga ajo se cili prej këtyre katër elementeve mbizotëron në trupin e njeriut natyra e tij është gjakanike, vreranike, melankolike ose neurotike. Çdonjëra nga këto natyra lind vese të posaçme, p.sh. njerëzit me natyrë gjakanike janë të hare-shëm dhe optimistë, të gjallë e të shkathët, shpejtë hidhërohen por shpejtë edhe qetësohen. Të natyrës vreranike janë të ngurtë, të vrazhdë, të pamëshirshëm, mendjemëdhenj, hipokritë, shpifës; ndërsa ata me natyrë melankolike kanë vullnet të dobët. Njerëzit me natyrë neurotike kryesisht janë shkaktarë të trazirave dhe pesimistë.

Kjo teori është e vjetër por ajo nuk e ka humbur krejtësisht fuqinë e përvojës. Nëse kësaj filozofie ia shtojmë problematikën mjaft të rëndësishme të filozofisë bashkëkohore mbi rolin e motivuesve dhe nxitësve në jetën tonë organike, atëherë nuk ka kurrfarë dyshimi se një pjesë e veseve tona rrjedhin nga natyra dhe temperamentin jonë. Secili prej nesh e di se nën ndikimin e klimës, moshës, profesionit ose sëmundjeve të ndryshme natyra e njeriut mund të pësojë ndryshime të mëdha.

A ekziston mundësia e përmirësimit të veseve të ndryshme

Veset e natyrës njerëzore, edhe pse është shumë vështirë, kemi mundësi t'i përmirësojmë. Për të ndikuar në këtë lloj të veseve duhet të ndikohet në faktorët të cilët janë shkak i paraqitjes së tyre, kështu që në këtë mënyrë mund të rregullohet natyra e njeriut.

Kjo është më tepër punë e mjekut se sa e moralistit. Me përjashtim të veseve të cilat paraqiten për shkak të sëmundjeve kalimtare dhe kronike, mendoj se te të gjitha veset tjera ekziston një element që ndikon në masë të madhe, e kjo është pastërtia shpirtërore dhe trupore. Një formë konkrete e saj gjithsesi është edhe sporti.

Vesi dhe sporti

Do të gabonim shumë po qe se sportin do ta shihnim si një mënyrë për fryerjen e muskujve, për bukuri trupore ose si përgatitje për kryerjen e shërbimit ushtarak. Sporti është metodë tejet e rëndësishme e edukimit shpirtëror, meqë nëpërmjet mekanizmeve organike ndikon dukshëm në shpirtin dhe karakterin e njeriut. Por ky funksion i sportit paraqitet nëse ai pikësëpari është tërheqës dhe i gjallë dhe së dyti, nëse bëhet në masë të caktuar. Sporti gjithmonë duhet ta ruajë formën e lojës te të rinjtë. Gjimnastika, gjegjësisht sporti që bëhet për notë dhe provim nuk ka kurrfarë ndikimi në shpirtin dhe karakterin e të riut. Por edhe sporti i cili zhvillohet në formë të lojës duhet të jetë me masë të caktuar. Çdo sport që e tejkalon masën është i dëmshëm edhe për shëndetin trupor por edhe për shëndetin shpirtëror.

Vesi dhe muzika

Asnjëherë nuk duhet të harrohet ndikimi i muzikës, i ushtrimeve dhe i kënaqësive gjuhësore në vëset që varen nga natyra e njeriut. Athinasit e vjetër bënë emër në histori në çështjen e arsimit dhe edukimit të të rinjve nëpërmjet gjimnastikës, muzikës, ushtrimeve gjuhësore dhe garave retorike. Çdo athinas për të qenë i arsimuar dhe i edukuar si duhet nevojitej t'i zotëronte bukur mirë gjimnastikën, muzikën dhe gjuhën me të gjitha karakteristikat e saj si trashëgimi e etërve të vet. Një gjendje identike e hasim edhe sot në shtetet perëndimore. Këto vende janë tepër të ndijshme sa i përket gjuhës kombëtare, respektivisht gjuhës e cila është në përdorim dhe në të cilën shkruhet. I riu, para së gjithash në mënyrë të përsosur e mëson gjuhën e vendit të vet. Nëse e shikojmë prapambeturinë dhe gjendjen tragjike të shkolave tona nga ky këndvështrim, gjithsesi çdo njeri patriot dhe atdhedashës do të dëshpërohej në masë të madhe.

Shprehitë shpirtërore dhe fuqia e vullnetit

Përfundimisht sqaruar se burim i një pjese të konsiderueshme të veseve tona janë shprehitë, gje-gjesisht automatizmi shpirtëror, mjedisi shoqëror dhe kushtet e punës. Mekanizmat e çështjeve të sipërpërmendura i shqyrtoam në faqet paraprake. Ashtu siç shprehitë shpirtërore paraqiteshin me për-

sëritjen e lëvizjeve të njëjta dhe herë e sistematizojnë e herë e robëronin jetën tonë fizike, ashtu edhe shprehitë shpirtërore paraqiten po në këtë mënyrë dhe marrin formën e vesit. Por, kujdes, robëria e veseve të shëmtuara të paraqitura nëpërmjet shprehive është shumë më e rëndë se robëria e qeve në zgjedhë.

Përsëri kujdes, njeriu në robërinë e shprehive të shëmtura fizike dhe shpirtërore hyn në hap të parë. Siç thamë edhe më parë, shprehitë e pirjes së duhanit dhe alkoolit fillojnë prej një cigareje dhe një gote. Edhe shprehitë shpirtërore të formësuara si vese janë të tilla. Gënjeshtaria me një gënjeshtër, mungesa e vullnetit me një përtaci si dhe sjellja artificiale me një lëvizje fillojnë, pastaj marrin formën automatike dhe në fund bëhen anime dhe cilësi shpirtërore të cilave vështirë mund t'u bëjmë ballë. Në të vërtetë mëkati i parë në të shumtën e rasteve nuk është mëkati më i madh, por ka rëndësi të madhe pse pikërisht është i pari.

Nëse përqëndrohemi pak më tepër do të shohim se pas automatizimit shpirtëror, një pjesë e madhe e ekzistencës sonë është përfshirë nga ana e veseve të përcjella nga shokët e afërm, familja, mjedisi jetësor dhe puna të cilën e bëjmë, kështu që veset e ndikuara nga ana e edukimit dhe arsimimit e përbëjnë shtresën e fundit të tyre. Gjegjësisht, shprehitë shpirtërore janë shprehi të përvetësuara nga tradita, mjedisi shoqëror dhe jeta profesionale. Në të vërtetë luftimi i këtyre veseve të bëra shprehi dhe të përforcuara si shkëmbi në personalitetin tonë është shumë i vështirë. Pikërisht për këtë qëndrimi anësh ose lar-

gimi prej veseve të tilla është më i përshtatshëm se sa përmirësimi pas përvetësimit të tyre. Është e qartë se pengimi i një të shëmtuare është më i favorshëm se sa çrrënjësja e saj e mëvonshme.

Lexuesi im i ri! Ki kujdes gjatë depërtimit në botën e shprehive. Mendo bukur mirë dhe zotëro vullnetin tënd, orvatu që të mos shkelish në kalldrëmin e rrugës së shëmtuar. Nëse vepron kështu, nuk do të jeshë i detyruar t'i pastrosh këmbët nga balta. Sa e sa të pafatë ka që sot jetën e tyre e kalojnë pranë tryezave të bixhozit, në qoshtet e kafeneve dhe ulëset publike, kurse janë viktima të hapit të parë të hedhur në rrugë të gabuar.

Obligimi dhe përgjegjësia e familjes dhe shkollës kanë rol të rëndësishëm në çështjen e sipërpërmendur. Familja dhe shkolla së bashku duhet të bëjnë përpjekje të mëdha që fëmijët të mos i përvetësojnë shprehitë e shëmtuara dhe t'ua prezentojnë atyre shprehitë e mira dhe me vlerë. Assesi nuk duhet harruar se nëse qëllimi i parë i edukimit është shpëtimi i të fundosurit, qëllimi i dytë i tij është që ta pengojë fundosjen. Për fat të keq, shkollat tona janë shumë pak ekspeditive në këtë drejtim.

Përmbyllje

Në fund, në përmbyllje të kësaj teme duhet të theksojmë se veset tona nuk janë të një lloji e as që paraqiten si përfundim i faktorëve të njëjtë. Një pjesë e veseve tona na përcjellin që nga lindja meqë ja-

në të trashëguara ose organike, respektivisht ose i kemi fituar bashkë me lindjen ose i kemi të ngarkuara si ndikim dhe rezultat i natyrës sonë. Por, një pjesë e veseve tona janë të përfituara. Këto vese i kemi përvetësuar duke filluar nga prehëri i nënës, familja, shkolla e deri te ndikimet e mjedisit jetësor dhe në këtë mënyrë i kemi bërë pjesë të unit tonë shpirtëror.

Vetëm armiqtë e mi le të besojnë se veset e trashëguara mund të çrrënjosen. Veset e lindura prej natyrës, edhe pse tejet vështirë, mund të ndryshohen, ndërsa veset e përfituara dhe të bëra shprehi mund t'i përmirësojmë me një përpjekje individuale dhe vullnet të fortë. Këta mysafirë ogurzi që i kemi pranuar pa vetëdije duke ua hapur dyert dhe dritaret e individualitetit tonë, mund t'i largojmë vetëm me dritën e mendjes dhe udhëheqjen e vullnetit. Edukimi i karakterit ka po këtë qëllim. Kjo edukatë është përpjekje për çrrënjosjen e veseve të shëmtuara që i varen mbi kokë individualitetit tonë.

Por, duhet të kemi kujdes se kur themi që veset e trashëguara nuk ka mundësi të ndryshohen, kjo nuk do të thotë se nëpërmjet moralit, sjelljes së mirë dhe përpjekjeve të ndryshme nuk mund të përmirësohen. Assesi nuk duhet të dyshohet në ndikimin pozitiv të edukimit të karakterit mbi veset e shëmtuara. Ne nuk kemi mundësi të dijmë se cilat prej veseve tona janë të trashëguara, cilat organike e cilat fryt i shprehisë. Shkenca dhe arti këtu janë të paaftë. Nuk është e mundur që njeriu të kontrollohet dhe t'i tregohet atij se cilat vese të tij janë prej lindjes e cilat të përfituara. Në të vërtetë të gjitha veset tona janë sintezë e errët e elementeve të ndryshme të trupit tonë

si idetë, ndieshmëria, instinktët dhe prirjet. Sot ende nuk e kemi të njohur madje as mekanizmin psikologjik të ndikimit të këtyre elementeve në veset tona. Si pasojë e kësaj, edukimi i karakterit dhe përpjekja individuale e ruajnë vlerën e tyre ndikuese në veset tona të trashëguara, organike dhe të shprehisë.

Njëkohësisht, edhe veset më të qëndrueshme nëpërmjet edukimit të karakterit dhe përpjekjes individuale mund të kufizohen dhe mbyllen brenda karakterit tonë. Dijetari, prifti për të cilin ju fola më parë, një ditë më tha: “Sikur të mos isha bërë prift dhe të mos i qasesha përpjekjes individuale do të bëhesha hajn, meqë unë këtë e kam brum”. Gjatë mendimit dhe përvojës së mëtutjeshme e kuptova këtë fjalë, si dhe e kuptova se edukata dhe përpjekja individuale janë zinxhirë për veset, mundësitë dhe prirjet e shëmtuara. Veçanërisht dita-ditës me pasurimin e përvojave të mia edhe më tepër jam duke i besuar ndikimit të edukimit fetar dhe dashurisë hyjnore mbi veset dhe moralin e njeriut. Edukata jashtë ndjesisë dhe dashurisë hyjnore nuk ka kurrfarë vlere, ndërsa edukata islame është e lartë dhe shpirtërore. Kjo edukatë e fiksikëron njeriun dhe e nxitë që pa kurrfarë interesi t’i adhurojë të mirën dhe drejtësinë.

IV

Suksesi dhe puna frytdhënëse

Shprehje etike e edukatës së vullnetit janë puna dhe përpjekjet

Më lartë theksova se kushti i parë i suksesit është të qenit i vullnetshëm. Nëse mendojmë pak më thellë, shprehja më etike dhe më njerëzore e edukatës së vullnetit dhe përpjekjes individuale është puna. Përtacia dhe parazitizmi janë bazë e çdo mungese të moralit, kurse puna është kushti themelor dhe burimi inspirues i pastërtisë, suksesit, moralit të lartë dhe shëndetit të shpirtit e trupit.

Në momentin kur e them këtë, gjithsesi i kam parasysh shembujt e shëmtuar. Edhe unë e di se ekziston një grup i madh i njerëzve që janë pasuruar pa punë dhe janë ngritur duke e shtypur kurrizin e tjetërkujt. Por, unë ty të këshilloj dhe të flas për suksesshmërinë e njerëzve të pastër dhe të sjellshëm dhe ky sukses ka vetëm një rrugë: punën, gjegjësisht pasurinë e përfutur si e drejtë dhe përpjekje individuale. Për një njeri shpirtpastër, lumturia arrihet vetëm me një sukses të këtillë.

Por, kujdes, vlera e punës nuk qëndron në sasinë por në cilësinë. Vetëm puna frytdhënëse i siguron njeriut sukses. Mençuria nuk qëndron në thelbin e punës por në frytshmërinë e saj, gjegjësisht në përfitimin e dobisë materiale apo shpirtërore nga ajo.

Të jeshë i bindur se kushti parësor i të qenit i suksesshëm është puna metodike dhe frytdhënëse, qoftë për individin qoftë për shoqërinë. Pikërisht për këtë nevojitet njohja e metodës dhe fshehtësisë së punës frytdhënëse.

Kushtet e punës frytdhënëse

Sipas mendimit tim, puna frytdhënëse ka tre kushte parësore: kushti trupor, ndjesor dhe mendor. Nëse hasim në njerëz të cilët punojnë por nuk kanë sukses në punën e tyre, atëherë kjo do të thotë se atyre u mungon njëri prej këtyre kushteve. Cilat janë këto kushte?

Kushti trupor i punës është shëndeti, kushti ndjesor-dashuria ndaj punës dhe kushti mendor-njohja e metodës dhe kahes së punës. Sa i përket shëndetit, ti mendo vetë, ndërsa për dy kushtet tjera do të mendojmë bashkë.

Kushti ndjesor i punës frytdhënëse

Thash edhe më lartë se kushti i produktivitetit dhe rezultimit të mbarë të punës janë dashuria dhe

ndjesia ndaj punës. Ta duash punën jo si diç e kotë por si sport. Edhe dashuria ndaj punës ka shumë kushte. Njëri prej këtyre, sipas meje kryesori, është zgjedhja e punës dhe profesionit sipas fuqisë shpirtërore dhe trupore, prirejeve dhe mundësive të lindura.

Shoku im i ri! Askënd nuk e ke më afër se veten. Vetën mundohu ta njohish vetë. Zgjedhe punën dhe profesionin sipas mundësive tua, ashtu që të punosh me dashuri. Nuk mund të paramendohet një jetë më e keqe se ajo kur njeriu është i detyruar të punojë një punë që nuk e don, ose të punojë një punë që për këtë ose atë shkak është i detyruar ta bëjë. Njeriu i këtillë nuk është zotërues i punës por rob i saj. Lloj tjetër i punës është ajo ku njeriu punon si rob dhe prej saj nuk kanë dobi as individi e as shoqëria. I lumtë njeriut që punon një punë të cilën vetë e ka zgjedhë dhe e kryen me dashuri. Ai që punon me dashuri nuk lodhet kurrë si dhe nuk ndjenë zili ndaj suksesit të të tjerëve. Nga dita në ditë përparon në punën e tij, duke përparuar i shtohet dashuria ndaj punës dhe punon me një vullnet edhe më të madh. Prej një botëkuptimi dhe pune të këtillë kanë dobi si individi ashtu edhe shoqëria edhe i tërë njerëzimi.

E kam tejet të qartë se sot është shumë vështirë që njeriu të kapet për punën të cilën e adhuron. Shumë pak njerëz ia arrijnë qëllimit që të kryejnë punën që e pëlqejnë, për arsye se në shoqëritë tona ende nuk ekziston një organizim i mirëfilltë i punës dhe orvatja racionale. Punët nuk janë të bazuara në baza racionale, të kapacitetit o të forcës, por janë në rastësi dhe domosdoshmëri jetësore. Prandaj sot është begati e madhe që njeriu ta punojë punën që ia do zem-

ra. Shumica prej nesh kapen për punë ose me sugjerim të shokëve, farefisit ose edhe më keq, rastësisht dhe me prirje të nevojave jetësore, kështu që ose e vazhdojnë punën pa kurrfarë zelli ose e ndërrojnë profesionin. Në të vërtetë, profesioni i zgjedhur në rini nuk mbetet i përjetshëm, kështu që ekziston mundësia që në të ardhmen të ndërrohet dhe të përmirësohet gabimi i bërë. Por koha e kaluar ka shkuar dhe rasti i zgjedhjes së profesionit në rini ka ikur.

Në Francë u njoftova me një aktor të një shtëpie të operës. M'u prezentua si doktor i drejtësisë. U habita. Ma sqaroi punën: "Babai im ishte noter në Tuluza. Ai dëshironte që edhe unë të shkoj hapave të tij. Pas gjimnazit me urdhrin e tij vazhdova drejtësinë. Mbarova magistraturën dhe doktoraturën. Kur shpëtova nga despotizmi i babait, u hodha në jetën teatrore të cilën e doja që nga fëmijëria. Shpresoja se një ditë do të bëhem aktor i klasës së parë. Por kisha mbetur vonë. Jo aktor i klasës së parë, por nuk u bëra dot as i klasës së tretë", - tha dhe iu mbushën sytë me lot.

I respektuari lexues, unë të dhash një shembull në mesin e një mijë të tillëve. Në jetë do të shohësh shumë doktorë të cilët pas të dyzetave do të hedhen në politikë. Do të hasish në me njerëz të cilët orvaten ta rregullojnë shtetin, kurse janë të paaftë ta udhëheqin madje edhe shtëpinë e vet. Të gjithë këta janë viktima të zjarrit të fshehtë, zgjedhjes jo të drejtë të profesionit.

Përcaktimi për profesionin e dëshiruar është tejet i vështirë, prandaj njeriu në rini nuk ka mundësi që t'i masë forcat dhe mundësitë e veta ashtu si du-

het. Kryelartësia rinore, mungesa e përvojës, gjaknxehtësia janë pengesë për këtë. Prandaj në këtë pikëpamje të rinjve duhet t'u dalin në ndihmë të rriturit dhe shkolla. Në shkolla nëpërmjet metodave psikologjike duhet të konstatohen mundësitë dhe intelekti i nxënësit, kështu që në këtë mënyrë gjimnazistit të ri i tregohet rruga e zgjedhjes së profesionit dhe punës së qëlluar. Në pritje që edhe në vendin tonë të praktikohen këto rregulla të cilat në disa vende praktikohen me sukses, do të të jap një këshillë të mirë ty, o lexuesi im i ri: **Para se ta zgjedhish profesionin, në fillim mati fuqitë mendore dhe mundësitë. Provo prirjen individuale para se të kapesësh për traditën dhe sugjerimet e jashtme dhe dëgjoje zërin e brendshëm. Mos iu drejto ndonjë profesioni që nuk e adhuron aspak dhe mos dysho fare, pasi të gjitha profesionet dhe punët janë të mira.** Mjafton që ti të jeshë i dhënë pas punës që e kryen. Por, nëse dëshiron të bëhesh zotërues i punës tënde, atëherë duhet ta duash punën dhe të punosh me dashuri, për arsye se, të përsëris, fshehtësia e suksesit fle në punën e dashuruar. Nëse njeriu punon një punë që nuk ia do zemra, atëherë asnjëherë nuk do të mundë ta kryejë siç duhet. Zemra e tij vazhdimisht do të jetë e lidhur për punën e dëshiruar.

Me këtë rast më duhet të shtoj edhe atë se metoda e cila zbatohet në mënyrën e pranimi të studentëve në universitetet tona është e gjymtë dhe i pengon të rinjtë që ta zgjedhin profesionin e dëshiruar. Paramendoni, djali i një farmacisti që tërë jetën e ka kaluar me ilaçe të ndryshme, në fund nuk arrin të re-

gjistrohet në fakultetin e farmacisë dhe atij ia tregojnë rrugën e letërsisë. Ky është një dëm i madh jo vetëm për mundësitë individuale të individit por edhe për vetë shtetin.

Konkretisht, kur mendoj se sa e sa energji dhe mundësi shkatërrohen dhe kalojnë në pesimizëm vetëm për shkak se nuk mund ta zgjedhin punën që u përgjigjet forcave dhe mundësive konkrete, e shoh se sa jemi mbrapa në pikëpamje të ndarjes së drejtë të punës dhe profesionit.

Një profesor universitar një ditë më tha se i urrenë librin dhe leximin. Gjithashtu edhe një mjek me një rast më tha se është bezdisur nga të sëmurët. A nuk është kjo një jetë e pafat? Por faji i vetëm i këtyre njerëzve qëndron në atë se ata kanë zgjedhur rrugë të gabuar. I nderuari lexues! Qëllimi kryesor i njeriut nuk janë pozita, pasuria dhe fama, por lumturia. Kushti kryesor i lumturisë është që njeriu të jetojë në pajtim me brendinë e vet. Më dëgjo mua! Gjithmonë mundohu t'i mbash në pajtim brendinë dhe profesionin. Qetësia dhe lumturia mbështeten në këtë pikë.

* * *

Puna frytdhënëse dhe drejtësia

Pak më sipër theksova se kushti i parë i dashurisë ndaj punës është zgjedhja e drejtë e profesionit. Por kjo nuk mjafton meqë nevojitet realizimi edhe i një kushti tjetër. Është e domosdoshme që njeriu të

mos dyshojë në atë se do t'i shkelet e drejta dhe nuk do të ngrihet në vendin e merituar. Kësaj çështjeje juristët i thonë - *drejtësia e ndarjes*. Kjo e drejtë është shkaku dhe urtësia kryesore për jetën e njeriut brenda strukturave të shtetit. Nuk dëshiroj, për shkak të konceptit të librit, t'i hyj kësaj problematike e cila është fundament i sistemit shtetëror.

Të shkojmë ngadalë dhe ta kuptojmë mirë problematikën. Suksesi është në varshmëri të drejtpërdrejtë me orvatjen metodike dhe frytdhënëse. Që puna të jetë frytdhënëse, individi duhet ta dashurojë profesionin e vet, pasi në të kundërtën assesi nuk mund të përparojë. Por t'i lëmë anësh përjashtimet dhe rastësitë. Sipas meje, përkufizimi është ashtu siç u tha më lartë. Populli në mënyrë tejet konkrete e ka shprehur këtë realitet në një proverb të vetin: “ Pa dashuri nuk ka muzikë të mirë”.

Njohja e metodës së punës - më se e domosdoshme

Në rrugën e suksesit nuk mjafton vetëm dëshira, por duhet të dihen edhe shkenca dhe metoda profesionale e muzikës. Me këtë rast është e domosdoshme të punohet në mënyrë metodike dhe sistematike, prandaj kushti i dytë i punës frytdhënëse është ndjekja e metodës dhe sistemit të suksesshëm. Po që se e vëreni me kujdes, dashuria ndaj punës lindet nga puna metodike. Ai që nuk punon në këtë mënyrë assesi nuk mund ta adhurojë punën, për arsye se pu-

na pa metodë dhe sistem të mirëfilltë nuk është fryt-dhënëse.

Por, për fat të keq, si në shkolla ashtu edhe në jetën profesionale ne shumë pak rëndësi u kushtojmë këtyre gjërave. Shumica prej nesh si në jetën profesionale ashtu edhe në atë normale pa mos menduar tepër, pa mos llogaritur fare dhe pa sistem të nevojshëm i hedhemi një punë, kështu që përpjekjet tona mendore dhe fizike janë të kota. Gjithnjë kur i mendoj talentet që shuhen dhe energjitë që shkatërrohen Dekarti edhe më shumë rritet në sytë e mi. Ky filozof që në Perëndim hapi hullinë e punës metodike, pohon se suksesi në punë arrihet nga puna metodike e jo nga mendja e përkapja. Nëse këtë ide e zbatojmë edhe te popujt tjerë, jam i bindur se edhe ata mund të bëhen të suksesshëm. Edhe ne si popull nuk jemi më pak të mençur se perëndimorët, por na mungon përdorimi metodik dhe racional i intelektit.

V

Ligjet e jetës profesionale dhe suksesit të përgjithshëm

Ligjet e përgjithshme të jetës profesionale

I nderuari lexues! Çdo punë dhe profesion në strukturën e vet ka rregullat dhe metodën e vet të punës. Këtë të vërtetë njerëzit e atij profesioni e dinë mirë. Por, njëkohësisht edhe jeta ideore dhe fizike si dhe sukseksi i kanë ligjet e veta të përgjithshme racionale. Këtu do të mundohem t'i theksoj vetëm disa që unë i di:

- Mos prit kohë dhe ditë të qëlluara për punë. Dije se çdo orë dhe çdo ditë është e qëlluar për punë.
- Mos kërko vend të përshtatshëm për punë. Dije që çdo skutë është vendi më i përshtatshëm i punës.
- Assesi punën e sotme mos e lë për nesër, për arsye se çdo ditë i ka vështirësitë dhe punët e veta.
- Në një kohë të caktuar bëre vetëm një punë, vetëm një mësim, respektivisht puno rreth një prob-

lemi derisa mos të dobësohen kujdesi dhe fuqia. Nëse thua se do të bëshë më shumë punë për një kohë, atëherë asnjërën prej tyre nuk do të mund ta bësh si duhet. Dijetarin e famshëm Gazaliun me një rast e kanë pyetur si e ka shkruar kryeveprën e tij *"Ihjau Ulumiddin"*. Në këtë ai është përgjigjur se brenda një kohe të caktuar është përqëndruar vetëm rreth një subjekti, çështjeje dhe pjese.

- Pa e kryer një punë, mësim, libër apo obligim që e ke filluar mos kalo në tjetrën. Puna e mbetur përgjysmë është sikur të mos jetë nisur fare.
- Pasi ta kryesh punën e ditës së sotme, vendos se çka do të bësh nesër. Ose, së paku para se ta fillosh punën, vendos se cilën punë do ta bësh.
- Para se ta fillosh punën, mësimin ose librin pranë vetes merri të gjitha gjërat të cilat do të nevojiten gjatë kryerjes së tyre, ashtu që mos të të humbë kujdesi duke u ngritur pandërprerë për të marrë letër, laps, etj.
- Në momentin kur nuk ke mundësi të përballosh një problem rreth çështjes të cilën e punon, assesi mos bën hap prapa. Dije që lëshimi pe është përtaci e maskuar. Duhet ta dishë se dashuria ndaj punës lindet dhe forcohet përmes përballimit të problemeve. Kënaqësia shpirtërore që paraqitet pas kapërcimit të problemeve është e pashoq. Të jeshë i sigurt se ngadhënjimi në luftë dhe sukcesi në punë janë me atë që nuk kthehet prapa. Përpara këmbënguljes problemet shkrihen dhe të pamundurats bëhen të mundshme.

- Pikësëpari ndaje problemin me të cilin do të ballafaqohesh, pastaj përpiku që një nga një t'i zbërthesh pjesët e tij. Pikërisht në këtë mënyrë edhe mësimin dhe librin që e lexon ndaji në pjesë më të thjeshta dhe më të shkurta. Para se ta kuptosh mirë një pjesë mos kalo në tjetrën. Kalo si i verbëri me shkop mbi të gjithë kapitujt, respektivisht mos e hedh hapin e ardhshëm pa qenë i sigurt për të parin.
- Puno vazhdimisht dhe me kujdes, si dhe çdo ditë puno në të njëjtën kohë. Mos e ndërpre punën me ndërprerje të gjata. Nëse nuk je i sëmurë dhe i lodhur puno ngapak edhe gjatë pushimeve, ashtu që të mos e humbësh shprehinë e punës dhe ta kesh vështirë t'i kthehesh përsëri.
- Nëse lodhesh me një punë atëherë ndërroje atë ose ngadalësoje ritmin, por assesi mos gjej arsye për pushim. Organizmi i atij që rri kot është sikur hekuri që nuk punohet dhe ndryshket.
- Mendo mirë dhe dije se punë nuk do të thotë vetëm të lëvizish, të lexosh ose të shkruash. Njeriu që mendon, punon edhe më tepër se xehetari në minierë.
- Asnjëherë mos e vlerëso produktivitetin e punës me orë dhe mos thuaj mjaft. Shihe rezultatit e punës dhe atë që e ke mësuar.
- Në punët mendore dy-tri orë punë të pandërprerë mjaftojnë. Filozofi i madh musliman Ibn Sina veprën e tij të njohur "*esh-Shifa*" e ka shkruar me një punë dyorëshe çdo ditë pas namazit të mën-

gjesit, në skajin e një xhamie në Bagdad. Filozofi i madh anglez Spenseri veprat e veta i ka shkruar me një punë permanente dyorëshe në ditë. Shkrimtarin e njohur francez i cili për çdo vit ka shkruar nga një mijë apo një mijë e dyqind faqe, Emil Zolën, e kanë pyetur për fshehtësinë e suksesit të tij. “Çdo ditë punoj dhe shkruaj nga tri orë.” - është përgjigjur ai.

- Bëhu i qëndrueshëm shoku im i ri, bëhu i qëndrueshëm. Koka-koka bëhet oka.
- Në momentin kur mendon ta fillosh mësimin ose leximin e librit mos u bën i padurueshëm. Bëhu i qetë dhe i fortë. Ec por mos nxito. Puno dhe mëso duke kuptuar.
- Asnjëherë në punën tënde mos e nënçmo asnjë mendim. Mos harro se nga moskujdesi dhe nënçmimi shpeshherë paraqiten pasoja të rënda.
- Kur të shtrihesh në shtrat për të pushuar bëre llogarinë e asaj që ke bërë atë ditë dhe planifiko çka do të bësh të nesërmen.
- Çdo ditë lexo me zë nga dhjetë faqe të një vepre të mirë. Në këtë mënyrë do të zhvillohet aftësia yte e të folurit.
- Mësoi përmendsh pjesët e bukura që do t'i hasish në ndonjë libër filozofik ose letrar. Në këtë mënyrë do të pasurohen fjalori dhe shprehjet tua si dhe do të përforcohet mbamendja.
- Pas përfundimit të leximit të pjesëve të një libri, përsëriti ato në kujtesën tënde dhe merr shënime.

Mënyra më e mirë e përvetësimit të një njësie është pikërisht kjo.

- Pjesët dhe gjërat që i ke mësuar prej ndonjë libri më vonë diskutoi me shokët. Në këtë mënyrë do të zhvillohet intelekti yt dhe do ta kuptosh atë që e ke lexuar. Njëkohësisht do ta përfitosh shkathtësinë e të shprehurit të qartë të mendimeve dhe ideve.
- Ki kujdes: fjalët dhe shkrimet tua le të jenë të shkurtra, të qarta dhe të kuptueshme.
- Koha e punës mendore dhe produktiviteti i saj varren nga natyra e individit. Për dikë kjo kohë është në orët e hershme të mëngjesit, për dikë në mesditë, ndërsa për dikë tjetër në orët e vonshme të natës. Provo veten se cila kohë të përshtatet më tepër për punë dhe mos e harxho kot atë.
- Shëno faqen e një fjalie ose kaptine me rëndësi në librin të cilin je duke e lexuar. Këto shënime mblidhi në një vend të caktuar. Po që se në të ardhmen ke dëshirë të shkruash ndonjë libër, atëherë të gjitha këto shënime do të të ndihmojnë shumë.
- Nëse dëshiron të shkruash libër në çfarëdo qoftë teme, pikësëpari lexoi librat e shkruar rreth asaj teme, ashtu që të mos e harxhosh kot kohën duke i përsëritur temat e shtjelluara më parë.
- Në botë nuk ekziston kurrfarë mendimi krejtësisht i ri. Mendimi i ri është petk i ri i një mendimi të vjetër.

- Para së gjithash mëso të flasish dhe të shkruash mirë në gjuhën amtare. Gjëja më e rëndësishme për njeriun është gjuha e tij amtare.
- Njohja e gjuhës nuk është qëllim por mjet. Qëllimi i vërtetë është pasuria mendore.
- Vlera e individit është e fshehur nën gjuhën dhe në majën e lapsit të tij. Ajo shfaqet nëpërmjet fjalës dhe shkrimit.

* * *

- Në momentin kur do të hamendesh të fillosh ose të mos fillosh ndonjë punë, mendo për pasojat e të dy vendimeve. Zgjedhe atë nga i cili ke më shumë dobi e më pak dëm.
- Mos vendos t'i rrekesh ndonjë pune në gjendje të hidhëruar. Prit që të qetësohesh. Ai që ngrihet me hidhërim ulet i dëmtuar.
- Mos flit shumë, por flit me vend dhe domethënie. Vlera dhe ndikimi nuk mbështeten në fjalë të shumta, por në fjalët me vend dhe domethënie.
- Ki kujdes gjatë përdorimit të gjuhës dhe dije se plaga e shkaktuar nga gjuha dhemb shumë më tepër se plaga e shkaktuar nga thika.
- Atë që nuk e thua para syve mos e thuaj as pas shpine dhe dije se fjalët pas shpine janë forma më tronditëse e frikës.
- Mosdijen askujt mos ia përplas në fytyrë. Dije se theksimi i paditurisë në prani të tyre, do të jetë shkas për hidhërimin e bashkëbiseduesit.

- Mos gënje. Gënjeshtari është si vjedhësi i cili jeton me frikë se në çdo moment do të kapet.
- Para se të premtosh diçka mendo mirë, por kurrë mos e shkel fjalën e dhënë. Shkelja e premtimit është gënjeshtria më e keqe.
- Gjithnjë paraqitu si je dhe bëhu ashtu siç paraqitesh. Ai i cili mundohet të paraqitet ashtu si nuk është, vërtet është tejet mendjelehtë.
- Mos urrej dhe mos ndjej zili ndaj suksesit dhe lumturisë së askujt, por përpigu që edhe ti ta arrish këtë sukses dhe lumturi. Përpjekja është kushti i përparimit. Urrejtja dhe zilia janë dy armiqtë kryesorë të shëndetit, qetësisë shpirtërore dhe lumturisë.
- Bëhu bujar që të keshë shumë shokë. Dije se koprraci nuk ka shokë të sinqertë.
- Shokët fitoi në rini, meqë shokët e pleqërisë nuk janë të sinqertë.
- Edhe fuqia e verbër, “shansi”, është i dashuruar në bukurinë rinore. Mos e harxho kot rininë, por vlerësoje ashtu siç duhet.
- Bukuria e vërtetë e pëlqyer nga çdokush është bukuria e moralit, pasi njeriu me moral të bukur është i bukur në çdo moshë.
- Gjithmonë përpigu ta zbukurosh moralin. Bukuria morale është pasuria më me vlerë e njeriut.

- Shakatë që do t'i bësh edhe me shokët më të afërm, le të jenë tërheqëse. Nga shakatë e vrazhda as kafshët nuk argëtohen.
- Bëhu shok që të keshë shokë.
- Miqësinë vërtetoje në ditë të vështira, që të keshë miq në ditë të vështira.
- Bëhu besnik ndaj miqve, zemërgjerë ndaj armiqve dhe armikun i cili ka ra në tokë mos e shqelmo, bëhu shpirtmirë. Shpirtmirësia dhe besnikëria janë shtyllat kryesore të moralit të lartë.
- Ki respekt ndaj femrave. Përkujtohu se femra është nëna e njerëzimit.
- Mos i dëshpëro prindërit, pasi ai që i dëshpëron ata nuk shpëton dot.
- Shfrytëzoi përvojat e të moshuarve dhe assesi mos tento që t'i sprovosh njerëzit me përvojë sepse pendohesh shumë.
- Në fillim mendo mirë për punën për të cilën ndoshta do të pendohesh në mbarim të saj. Pëndimi i tillë është naivitet.
- Sillu mirë ndaj më të vegjëlve, ashtu që të keshë të drejtë që kur të rriten të presish prej tyre mirësi.
- Mos poho dhe mos këmbëngul në gjëra të kota. Kërko të vërtetën dhe adhuroje atë. Dashuria ndaj së vërtetës është dashuria më e lartë për njeriun.
- Vetë vëreji mangësitë, ashtu që të kesh mundësi përmirësimi.

- Mos u bën mendjemadh për shkak të suksesit tënd. Dije që mendjemadhësia është armiku më i madh i suksesit në të ardhmen.
- Bëhu guximtar në jetë, por ki kujdes, guximi nuk është hedhje në rrezik me sy të mbyllur.
- Shpreh respekt ndaj mendimit dhe besimit të të tjerëve, që edhe të tjerët ta respektojnë mendimin dhe besimin tënd.
- Mos i bën tjetërkujt asgjë që nuk dëshiron të të bëhet ty, ashtu që edhe të tjerët të mos veprojnë ashtu ndaj teje.
- Nëse dëshiron të të bëjnë mirë, atëherë edhe vetë bën mirë.
- E mira e bërë përballë një të mire është drejtësi. E keqja përballë një të mire është krim. E mira përballë të keqes është virtyt e bukuri dhe është shkalla më e lartë e humanitetit.
- Ndhimoje njeriun e shtypur, që të ndihmohesh nëse edhe vetë shtypesh.
- Fjalët tua le të jenë të ëmbla ndërsa sjelljet tërheqëse. Njeriu i vrazhdë është si qeni i hutuar të cilin e gjuan me gurë çdokush.
- Veprat e këqija të bëra ndaj teje nga ana e dikujt, assesi mos të të largojnë nga veprat e mira. Mirësia është dhunti, kurse veprat e këqija janë dëm për njeriun.
- Mos u bën kryelartë. Kryelarti i ngjason gojës që i vjen era e hudhrës. Secili largohet prej tij.

- Bëhu modest. Modestia i ngjason degës plot fryte. Lëshimi i degës me fryte deri në tokë bëhet për shkak të fryteve të shumta.
- Bëhu me vlerë si margaritari të cilin çdokush e lakmon. Mos u friko, nuk mbetesh përtoke.
- Shikoi njerëzit që janë më poshtë se ti e jo ata që janë më lart se ti, do të jeshë i qetë.
- Assesi mos u largo nga drejtësia në punët dhe fjalët tua. All-llahu është ndihmës i të vërtetave.
- Puno, gjithnjë puno, por qëndro larg pangopësisë, për arsye se pangopësia është armik i punës frytdhënëse, shëndetit dhe lumturisë.
- Puno, por mos u bën i pangopur. I pangopuri i ngjason maces e cila e lëpinë brinjën me pak mushkëri. Ajo njëkohësisht lëpinë edhe gjakun e gjuhës së vet të prerë, por nuk është e vetëdijshme për këtë.
- Zgjedhe në mënyrë të vetëdijshme njeriun me të cilin do të konsultohesh për çështjet problematike në jetën tënde. Mendo mirë, për shkak të një vendimi të gabuar të cilin do ta zbatosh në një moment, mund të vuash gjatë tërë jetës. Por, drita të cilën do ta fitosh prej një ideje me vend, do të të bëjë dritë gjatë tërë jetës.*

* Këtu do të përmend një kujtim të cilin assesi nuk mund ta harroj: Katër vjet qëndrova në Kaukaz dhe vrapova prej beteje në betejë në Luftën e Parë Botërore. Pasi u lirova nga ushtria u gjeta brenda një kaosi të madh. Çka do të bëja, çfarë rruge do të ndiqja në jetë? A ta vazhdoj shkollimin ose si shumë shokë të mi të hedhem në tregti? Assesi nuk mund të vendosja. Me

Shoku im i ri, këto këshilla që t'i dhash më sipër, nuk t'i dhash që t'i harrosh. T'i theksova që t'i keshë si vathë në vesh dhe të më përkujtosh në ardhmëri. Prej teje pres që të më përkujtosh për të mirë!

secilin që bisedoja më thoshte që t'i largohem shkollimit. Një ditë në një çajtare të Sirkexhisë në Stamboll u takova me një bashkëqytetar timin. Kishte ardhë për të marrë mall. Më pyeti se çka do të bëja në të ardhmen. I thash se nuk kam vendosur, por se mendoj që ta vazhdoj shkollimin. U habit dhe më tha: "Do ta vazhdosh shkollimin dhe do të bëhesh mi i bibliotekave, eja në tregti dhe bëhu i pasur!". Ky miku im i cili vdiq herët, e tronditi edhe më shumë shpirtin tim.

Në fund vendosa që të shkoj te një hoxhë efendi të cilin e raspektoja shumë - Shefket efendiun. E vizitova në shtëpinë e tij në Çarshikapi. Hoxhë efendiu më pyeti se çka do të bëja. I tregova se ende nuk kam vendosur. Ai më tha që ta vazhdoj shkollimin, se tregtia mund të bëhet në çdo kohë, kurse shkollimi ka kohë të caktuar. "Pikësëpari mëso, pastaj nëse do bëhu tregtar. Këtu nuk ka dëm". Këtë këshillë ia rrëfeva edhe shokut tim të nderuar, Kemal Galip Ballkirit. Edhe ai edhe unë e vazhduam shkollimin. Zotëri Kemali u bë njëri nga juristët më të njohur të Turqisë. Rahmeti i Allahut qoftë mbi Shefket efendiun.

Rini e dashur

Këtu kemi shprehur dëshirë që t'ua prezentojmë përvojat e një mësuesi tuaj që ka kaluar nëpër rrugët që i kaloni edhe ju, i cili është ballafaquar me problemet e njëjta, i cili ka punuar shumë që t'i kapërcejë ato dhe i cili në fund ka arritur sukses të jashtëzakonshëm në këtë drejtim.

Jemi të mendimit se njëri nga shkaqet kryesore të pesimizmit të të rinjve tanë, humbjes së shpresave të tyre dhe përjetimit të tronditjeve shpirtërore qëndron në privimin nga udhërrëfyesi.

Ky libërth i cili ka për qëllim shpëtimin tënd, rini e dashur, e cila je shpresa jonë e ardhmërisë - nga kthetrat e krizës, jeta pa vullnet dhe pa kurrfarë shprese, i zbulon fshehtësitë e të qenit i suksesshëm.

Ky libërth i cili ju mbron nga përtacia, shoku i keq, libri i dëmshëm dhe indoktrinimet e ndryshme, njëkohësisht ua mëson punën e ndershme dhe frytdhënëse.

Ky libërth u është rekomanduar të gjitha shkollave të mesme nga ana e Ministrisë Turke për Arsim Kombëtar.

Përmbajtja

Jetëpërshkrimi i autorit.....	5
Para se të fillojmë.....	9
I. Rreziqet dhe armiqtë e rrugës së suksesit.....	19
Armiku i parë i suksesit është përtacia.....	20
Armiku tjetër i suksesit është edhe shoku i keq.....	22
Armiku tjetër i suksesit është shembulli i keq.....	23
II. Kushtet e suksesit.....	27
Kushti i parë i suksesit është vullneti.....	27
Mendime rreth vullnetit.....	29
Ç'është vullneti dhe çfarë do të thotë të kesh vullnet.....	31
Lëvizjet tona dhe ato që nuk janë tonat.....	33
Reflekset dhe lëvizjet automatike.....	34
Lëvizjet instinktive.....	34
Shprehjet.....	35
Sugjerimet.....	37
Lëvizjet e vetëdijshme dhe vullneti.....	38
Vullneti etik.....	39
III. Ndikimi i edukatës në shpirtin dhe karakterin njerëzor.....	41
Natyra dhe karakteri.....	41
Kuptimet e fjalës karakter.....	42
Njerëzit kanë karaktere dhe natyra të ndryshme.....	43
Dy interpretime dhe dy përgjigje.....	45
Teza mbi atë se edukata nuk luan rol të rëndësishëm në karakterin dhe shpirtin.....	45
Interpretimi pozitiv.....	48
	81

Fatalizmi dhe fatalistët në pedagogji (edukatë).....	49
Disa vese kemi mundësi t'i përmirësojmë kurse disa të tjera assesi.....	51
Trashëgimia dhe veset e trashëguara.....	52
Veset e trashëguara nuk mund t'i ndryshojmë	53
Veset e natyrës njerëzore.....	53
A ekziston mundësia e përmirësimit të veseve të ndryshme	54
Vesi dhe sporti.....	55
Vesi dhe muzika.....	56
Shprehitë shpirtërore dhe fuqia e vullnetit	56
Përmbyllje	58
IV. Suksesi dhe puna frytdhënëse	61
Shprehje etike e edukatës së vullnetit janë puna dhe përpjekjet	61
Kushtet e punës frytdhënëse.....	62
Kushti ndjesor i punës frytdhënëse	62
Puna frytdhënëse dhe drejtësia	66
Njohja e metodës së punës - më se e domosdoshme	67
V. Ligjet e jetës profesionale dhe suksesit të përgjithshëm	69
Ligjet e përgjithshme të jetës profesionale.....	69

Ali Fuad Bashgil
KOKË MË KOKË ME TË RINJTË

Redaktor gjuhësor - korrektor
Fatmire Ajdini - Hoxha

Krahasoi me origjinalin
Mr. Ali Pajaziti

Përgatitja kompjuterike dhe shtypi
Focus - Shkup

Boton
Sh.B. *Logos-A*
II Mak. brigada, QT "Treska" X / 7
1000 Shkup
Tel. (091) 600-036; fax: 611-508
www.logos-a.com.mk
logos-a@mt.net.mk

ISBN - 9989-904-10-



9789989904103